



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality of Prishtina



STRATEGJIA PËR AGROTURIZËM 2025-2029



Tetor, 2024

TITULLI I PROJEKTIT:

“Përpilimi i strategjisë për agro turizëm dhe ngritje kapacitetesh”

NUMRI I KONTRATËS:

616-24-4096-2-2-1/C1477

OPERATORI EKONOMIK



D&D BUSINESS SUPPORT CENTER

Rr. "Xheladin Hana", Ndërtesa Iliria,
10000 Prishtina, Republika e Kosovës
Tel.: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564
E-mail: info@dd-bsc.com
Web: www.dd-bsc.com

AUTORITETI KONTRAKTUES:



KOMUNA E PRISHTINËS

Rr. “UÇK”, nr.2
10000 Prishtina, Republika e Kosovës
Tel.: 038 230 900
E-mail: [komunaprishtine@rks-gov.net](mailto:komonaprishtine@rks-gov.net)
Web: www.kk.rks-gov.net/prishtine

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës	6
1. Vështrimi i Përgjithshëm Ekzekutiv	7
2. Fjalori i termave dhe Akronimet.....	10
3. Hyrje	13
4. Metodologjia dhe Struktura.....	15
4.1. Fazat kryesore të Hartimit të Strategjisë	15
4.2. Vlerësimi i gjendjes së Turizmit në Kosovë dhe Komunën e Prishtinës.....	16
4.3. Një përmbledhje e shkurtër e zhvillimit të turizmit në Kosovë.....	16
4.4. Niveli i arritur i Zhvillimit të Turizmit në Kosovë	17
4.5. Faktorët e ngecjes së zhvillimit të turizmit në Kosovë me fokus Prishtinën.....	17
4.6. Ndikimi i krizave në turizëm dhe ndryshimet në sjelljen dhe nevojat e turistëve.....	18
4.7. Rëndësia e zhvillimit të turizmit në Kosovë	18
4.8. Partneriteti publik dhe privat	19
4.9. Rajonet Turistike të Kosovës.....	19
4.10. Rajoni turistik Qendror i Prishtinës	20
4.11. Disa të dhëna bazë të statistikave lidhur me Turizmin në Kosovë dhe Rajonin e Prishtinës ...	20
4.12. Kapacitetet akomoduese turistike në Kosovë dhe Prishtinë, sipas llojit të akomodimit	20
4.13. Karakteristikat e përgjithshme të Destinacionit Turistik rajoni i komunës së Prishtinës.....	21
4.14. Raporti konkurrues i Destinacionit ndaj qendrave në rajonet tjera turistike të Kosovës.....	22
4.15. Zhvillimet dinamike historike ndër shekuj deri në ditët e sotme në rajonin e Prishtinës	23
4.16. Prishtina Kryeqytet i Kosovës, ndër qytetet më të mëdha në rajon	23
4.17. Historiku i Prishtinës dhe Rajonit komunal	24
4.18. Vlerat dhe gjurmët e traditës urbane të Prishtinës	27
4.19. Pozita Gjeografike e rajonit të Komunës së Prishtinës, Kryeqyteti dhe fshatrat përreth	27
4.20. Kushtet klimatike të komunës së Prishtinës	27
4.21. Burimet ujore të komunës së Prishtinës	27
4.22. Pyjet në zonat malore të komunës së Prishtinës	28
4.23. Popullsia e komunës së Prishtinës (regjistrimet 2024)	28
5. Niveli i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë dhe rajonin e komunës së Prishtinës	29
5.1. Kultivimi i drithërave në rajonin e Komunës së Prishtinës	29
5.2. Kultivimi i perimeve në rajonin e Komunës së Prishtinës.....	29
5.3. Kultivimi pemëve në rajonin e Komunës së Prishtinës.....	30
5.4. Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbra	30
5.5. Bimët mjekësore dhe frutat e malit në rajonin e komunës së Prishtinës.....	30
5.6. Zhvillimi i fondit të Bagëtive në rajonin e komunës së Prishtinës	31

5.7.	Bujqësia adaptive ose e përshtatur.....	32
5.8.	Agroekologjia, koncept dhe praktikë e re e avancimit integruar në sistemet bujqësore	33
5.9.	Zhvillimi i integruar rural në Zonat Rurale të komunës së Prishtinës	34
5.10.	Përkrahja e zhvillimit të integruar në zonat rurale të komunës së Prishtinës	35
5.11.	Zhvillimi i bujqësisë në zonat rurale të Komunës së Prishtinës	35
6.	Zhvillimi i Infrastrukturës si komponent kyç i Zhvillimit të Integruar Rural.....	36
6.1.	Zhvillimi i Agroturizmit në Zonat Rurale të Komunës së Prishtinës	38
6.2.	Hapat dhe strategjitë për zhvillimin e agroturizmit.....	40
7.	Resurset e Trashëgimisë Natyrore dhe Turistike të Rajonit të komunës së Prishtinës	42
7.1.	Zonat kodrinoro malore të Malësisë së Gallapit ose Gollakut	42
7.2.	Gjeografia e Gallapit	42
7.3.	Biodiversiteti i Malësisë së Gollakut.....	42
7.4.	Resurset Primare të trashëgimisë kulturore dhe historike të Komunës së Prishtinës	43
7.4.1.	Vlerat trashëgimore: përkatësia kosovare, evropiane dhe botërore.....	43
7.4.2.	Eventët kulturore dhe sportive në organizim nga Komuna e Prishtinës	47
8.	Vizioni dhe Objektivat e zhvillimit të Agroturizmit në Rajonin e komunës së Prishtinës	48
8.1.	Vendosja e objektivave të qarta Zhvillimi i Agroturizmit në Rajonin e komunës së Prishtinës	48
8.2.	Udhëzimet dhe orientimet zhvillimore të agroturizmit në Rajonin e Prishtinës	49
8.3.	Zhvillimi i Produktit Turistik të Rajonit të komunës së Prishtinës	51
8.4.	Hulumtimi i tregut turistik vendor, rajonal dhe ndërkombëtar	53
8.5.	Brendimi ose markimi i destinacionit të Agroturizmit në Rajonin e komunës së Prishtinës ...	55
8.6.	Plani Marketingut turistik për Rajonin e komunës së Prishtinës	56
9.	SWOT Analiza Zhvillimi i Agroturizmit në Rajonin e Komunës së Prishtinës.....	59
10.	Investimet në strukturat turistike dhe infrastrukturë	61
11.	Plani i Veprimit.....	63

Lista e Tabelave

Tabela 1. Numri i njësive akomoduese, dhomave dhe shtretërve sipas destinacioneve ose qendrave rajonale	21
Tabela 2. Numri i vizitorëve sipas Rajoneve turistike ose destinacioneve të qendrave rajonale	21
Tabela 3. Numri i netëqëndrimit sipas Rajoneve turistike ose destinacioneve qendrave rajonale	21
Tabela 4. Numri i ekonomive bujqësore sipas Regjionit	29
Tabela 5. Shpërndarja e sipërfaqes së kulturave foragjere dhe ekonomive bujqësore sipas regjioneve	30
Tabela 6. Numri i kafshëve sipas llojeve sipas vitit dhe Fondi blegtoral	31
Tabela 7. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i lopëve në Prishtinë, 2014	31
Tabela 8. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i deleve në Prishtinë, 2014.....	31
Tabela 9. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i dhive në Prishtinë, 2014	31
Tabela 10. Disa aspekte kryesore të bujqësisë adaptive ose të përshtatura ndryshimeve mjedisore.....	32
Tabela 11. Hapat dhe Strategjitë për zhvillimin e agroturizmit në rajonin e komunës së Prishtinës	40

Lista e Figurave

Figura 1. Pesë Rajonet turistike të Kosovës	19
Figura 2. Kolazh i fotografive të biodiversitetit nga Malësia e Gollakut	43
Figura 3. Mbretëresha e Dardanisë - Hyjnesha në Fron	44

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Prishtina, si kryeqyteti dhe epiqendra e zhvillimeve sociale dhe ekonomike të Kosovës, ka privilegjin dhe përgjegjësinë të udhëheqë me shembullin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm.

Përmes Strategjisë së Agroturizmit 2025-2029, ne po shënojmë një hap historik drejt një mbështetjeje të fuqishme për zonat tona rurale, duke e kthyer vëmendjen te natyra e pasur dhe traditat e lashta që përbëjnë thesaret tona kombëtare. Ky dokument strategjik synon të ndërthurë bukuritë e fshatrave tona me mundësitë për zhvillim ekonomik, duke krijuar një destinacion të veçantë ku kultura dhe natyra bashkëjetojnë në harmoni.



Duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e këtij sektori, unë jam i përkushtuar që ta mbështes këtë strategji jo vetëm në fjalë, por edhe në veprime konkrete. Si kryetar i Kryeqytetit, angazhohem të ndërmarrim hapat e nevojshëm për të investuar në infrastrukturën rurale, në përmirësimin e rrugëve, zhvillimin e qendrave për vizitorë dhe mbështetjen e familjeve bujqësore, për ta kthyer agroturizmin në një motor të fuqishëm ekonomik për Prishtinën dhe për Kosovën. Është koha të tregojmë se turizmi mund të jetë shumë më tepër se një sektor ekonomik – ai mund të shërbejë si rrugë për përmirësimin e jetesës, forcimin e identitetit tonë kulturor dhe krijimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për të gjithë.

Në këtë rrugëtim, ndihma e organizatave donatore dhe partnerëve zhvillimorë është e mirëpritur dhe e domosdoshme. U bëj thirrje të gjithë miqve tanë ndërkombëtarë që të bashkëpunojnë dhe të na mbështesin në realizimin e plotë të kësaj strategjie. Kontributi i juaj do të jetë me rëndësi të madhe për të siguruar që ky vizion i përbashkët të bëhet realitet, duke sjellë projekte që mbështesin zhvillimin rural, ruajnë ambientin dhe krijojnë përvoja unike për vizitorët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Falënderimet e mia të sinqerta shkojnë për Drejtorinë për Bujqësi në Komunën e Prishtinës, grupin punues dhe ekspertët e D&D Business Support Center, të cilët kanë treguar përkushtim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm në hartimin e kësaj strategjie. Ky dokument është rezultat i përpjekjeve të palodhura dhe përkushtimit për një Prishtinë më të gjelbër, më të hapur dhe më të zhvilluar. Besojmë se përmes kësaj strategjie, Prishtina do të shndërrohet në një model për zhvillimin e agroturizmit, duke frymëzuar qytete dhe komuna të tjera në Kosovë që të ndjekin një rrugë të ngjashme.

Së bashku, ne mund të ndërtojmë një Prishtinë që nuk është vetëm qendra e zhvillimit urban, por edhe një qytet i lidhur ngushtë me natyrën dhe traditat e tij. Kjo strategji na jep mundësinë që të ndërtojmë ura mes komuniteteve urbane dhe rurale, duke mbrojtur vlerat tona dhe duke i forcuar ato për të ardhmen.

Sinqerisht i juaji,
Përparim Rama

1. Vështrimi i Përgjithshëm Ekzekutiv

Përshkrimi i Projektit

Komuna e Prishtinës ka marrë vendim, ka shpallur dhe ka kontraktuar kompaninë për Hartimin e Projektit Planifikues “Strategjia e Zhvillimit të Agroturizmit dhe ngritjes së kapaciteteve,” dedikuar Rajoneve të Komunës së Prishtinës, prezantuar në këtë dokument të planifikimit strategjik. Përkundër faktit se Prishtina është lider i turizmit urban dhe kulturor, me numrin më të madh të vizitave, arritjeve, vizitorëve dhe fjetjeve në Kosovë, Prishtina – Kryeqytet, nuk ka bërë në mënyrë të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit në nivelin organizativ, planifikues dhe zhvillimor në nivelin institucional. Përgjithësisht ka munguar planifikimi strategjik në zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm, në ngritjen organizative dhe institucionale, në Kryeqytet dhe në Rajonin me potenciale dhe resurse të jashtëzakonshme natyrore dhe kulturore, në veçanti në planifikimin dhe përkrahjen e zhvillimit të formave të turizmit të komunitetit lokal, siç është Agroturizmi. Hartimi dhe aprovimi i “Strategjisë së Zhvillimit të Agroturizmit dhe ngritjes së kapaciteteve” do të siguronte bazën e domosdoshme planifikuese për ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve, për realizimin e propozimeve dhe rekomandimeve të parapara në këtë dhe dokumentet tjera planifikuese të relevancës turistike dhe të zhvillimit të integruar rural, të nivelit komunal dhe institucioneve qendrore. Investimi do të ishte një hap fillestar drejt zbulimit të potencialit turistik të turizmit përgjithësisht dhe turizmit të komunitetit rural lokal në veçanti, në Rajonin e Prishtinës.

Agroturizmi mund të vlerësohet si një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave për komunitetin që jeton në zonat rurale, ndihmon në krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Strategjia e Agroturizmit është një projekt shumë i rëndësishëm që synon të promovojë dhe zhvillojë sektorin e bujqësisë në rajonet përkatëse të kryeqytetit, duke tërhequr turistë dhe duke krijuar një industri të qëndrueshme turistike. Në këtë duhet të shfaqen resurset unike bujqësore, të trashëgimisë rurale dhe atraksionet natyrore të zonave të Kryeqytetit, në radhë të parë të Gallapit (Gollakut) por edhe të zonave të tjera më të ulëta rurale përreth Prishtinës, duke krijuar mundësi për fermerët që të diversifikojnë të ardhurat e tyre dhe që vizitorët të përjetojnë jetën autentike rurale. Nëpërmjet kësaj strategjie, duhet të nxisim ekonominë lokale, të ruajmë mjedisin dhe të forcojmë lidhjen midis komuniteteve urbane dhe rurale. Strategjia duhet të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm të integruar rural.

Kryeqyteti Prishtina ka potencial për zhvillimin e Agroturizmit në zonat rurale, pasi që ka të rregulluar, deri diku, infrastrukturën, si një nga elementet kryesore për implementimin e projekteve..

Gjetjet, njohuritë, analizat dhe rekomandimet e paraqitura në kuadër të Strategjisë janë rezultat i hulumtimit gjithëpërfshirës, angazhimit të komunitetit, kontakteve me palët e interesuara dhe bashkëpunimit me anëtarët e ekipit të angazhuar nga Komuna e Prishtinës. Projekti ka për objektiv përshkrimin e qartë të një udhërrëfyese për identifikimin, analizën dhe përshkrimin e potencialit dhe resurseve të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm të rajonit të Komunës së Prishtinës. Gjithashtu, projekti ka për objektiv edhe propozimin e rekomandimeve për investimet në ndërtimin e kapaciteteve strukturore, infrastrukturës dhe kapaciteteve të resurseve humane, si dhe markës së agroturizmit në Rajonin e Prishtinës.

Domosdoshmëria e Zhvillimit të Turizmit në Kosovë dhe Turizmit në Rajonin Qendror të Prishtinës

Nevoja imediate e zhvillimit të turizmit në Kosovë, në fokus Rajoni Qendror Turistik i Prishtinës

Turizmi është fenomen shoqëror dhe veprimtari ekonomike, njëra nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme bashkëkohore. Aktualisht, është njëra ndër industritë më të zhvilluara në tërë botën, veçanërisht në shtetet e zhvilluara, por me një hov pozitiv edhe në shtetet në zhvillim. Në kuadër të turizmit si industri bashkëkohore, ndër veprojë dhe janë të lidhura ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë e tjera njerëzore, ekonomike, sociale dhe politike.

Zhvillimi i turizmit në ekonominë e Kosovës dhe Rajonin turistik të Prishtinës do të ketë ndikime direkte dhe indirekte, ku ndër ndikimet më të rëndësishme direkte janë: ndikimi në produktin shoqëror, në shtimin e të ardhurave nacionale, në zhvillimin e veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike (mikpritja hoteliere, transporti, tregtia, institucionet kulturore etj.), në rritjen e punësisë, ngritjen e nivelit të standardit jetësor, në rritjen e investimeve, në përmirësimin e bilancit të pagesave dhe në zhvillimin e viseve të pazhvilluara etj.

Efektet indirekte të turizmit janë në ato veprimtari ekonomike, të cilat nuk marrin pjesë në shërbimet direkte të vizitorëve, por furnizojnë ekonominë turistike. Këto ndikime shfaqen, para së gjithash, në veprimtaritë ekonomike, siç janë: bujqësia, ndërtimtaria, industria, tregtia, artizanatet etj.

Definicioni dhe arsyet kryesore të turizmit dhe udhëtimeve

“Turizmi përfshin aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe vendosen në një vend jashtë vendbanimit të tyre të përhershëm, për qëllime pushimi, biznesi dhe qëllime tjera jo më gjatë se një vit”.

Brenda kufijve të kornizës së definicionit të turizmit, arsyet e udhëtimit mund të identifikohen si më poshtë:

- Udhëtime afariste, konferenca, ekspozita, seminare dhe aktivitete MICE.
- Udhëtime dhe vizita në qendra urbane dhe atraksione kulturore dhe historike.
- Pushime relaksuese në vende me diell dhe ajër të pastër, pushime në fshatra malore dhe lugina, qytete, shëtitje, lundrime në lumenj dhe liqene, etj.
- Ngjarje turistike me përmbajtje kulturore si: festivale artistike, festivale folklorike, koncerte klasike, pop, ngjarje sportive, përvjetorë tradicionalë, etj.
- Agroturizëm në bashkëveprim me komunitetin lokal rural dhe institucionet lokale dhe qendrore.
- Turizëm shëndetësor në viset malore, lugina atraktive, buzë lumenjve dhe liqeneve, dhe vende me ujëra termale.
- Vizita te miqtë dhe të afërmit.
- Pelegrinazhe etj.

Nevoja e zhvillimit të sektorit të turizmit në Rajonin Turistik Qendror të Prishtinës

Zhvillimi i sektorit të turizmit në rajonin e Prishtinës nuk ka të bëjë vetëm me shtrirjen hapësinore dhe pritjen e vizitorëve, por, për shkak të përmbajtjes së tij multiplikative, ai mund të ndikojë në mënyrë shumë efikase edhe në rritjen e të hyrave dhe zvogëlimin e papunësisë në destinacionin e Prishtinës, si në mjediset urbane ashtu edhe në zonat kodrinoro-malore dhe luginat në fshatrat e mrekullueshme të Prishtinës. Gjithashtu, mundëson zhvillimin e qëndrueshëm dhe shfrytëzimin efikas të resurseve natyrore dhe kulturore, në zhvillimin e baraspeshuar dhe të integruar me sektorët e tjerë (bujqësia dhe zhvillimi i integruar rural, etj.), në aktivizimin gjithëpërfshirës të komunitetit lokal, duke ndikuar edhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe mirëqenies. Përveç përfitimeve që ka popullata vendore, edhe komuna dhe shteti janë përfitues nga zhvillimi i industrisë së turizmit. Përfituesi tjetër nga turizmi i zhvilluar është edhe vetë komuniteti i biznesit turistik, si dhe komuniteti lokal i angazhuar në ofrimin e produkteve, shërbimeve dhe përvojave turistike për mysafirët lokalë, vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë diasporën/mërgatën..

Kuadri institucional, legjislativ dhe strategjik

- **Kuadri institucional** - Veprimtaria ekonomike e turizmit, në nivel të Kosovës, është përfshirë në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Inovacionit, si departament në kuadër të industrisë, me një numër të vogël ekspertësh dhe buxhet minimal, me një efikasitet relativisht të ulët. Ndërsa në nivelin komunal të Prishtinës, segmenti i turizmit akoma nuk është strukturuar dhe organizuar si njësi organizative në kuadër të drejtorive përkatëse. Projekti i Strategjisë është kontraktuar dhe përfshirë në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, segmenti i turizmit është përfshirë në mënyrë modeste dhe në nivel jo adekuat në Planin Zhvillimor Komunal (2012–2022). Duhet theksuar se, me ndryshimet e fundit dhe faktin se komuna ka vendosur të organizojë dhe financojë Planifikimin Strategjik të Agroturizmit dhe zhvillimit të kapaciteteve, turizmi është vlerësuar për herë të parë, duke e vendosur në prioritetet planifikuese dhe zhvillimore në mënyrë shumë më të gjerë. Në kuadër të planit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, mbase edhe në planin e ri Zhvillimor Komunal, është vënë në radhë hartimi i Strategjisë Zhvillimore të Agroturizmit dhe ngritja e kapaciteteve, duke synuar të shënojë ngritje të turizmit në një nivel më të lartë të prioriteteve zhvillimore.
- **Kuadri legjislativ** - Sa i përket përfshirjes së turizmit në rregullimin legjislativ, situata nuk është rregulluar si duhet, ngase me Ligjin mbi Turizmin, i cili është miratuar para dy vitesh dhe është në funksion, është përfshirë vetëm veprimtaria ekonomike e nën sektorit të turizmit dhe udhëtimeve, ndërsa janë lënë pa rregulluar veprimtaritë e mikpritjes hoteliere (hospitality) dhe gastronomisë. Gjithashtu, ligji ekzistues ka mjaft mangësi dhe duhet rishikuar.
- **Kuadri strategjik** - Zhvillimi i turizmit asnjëherë nuk ka qenë i kuptuar dhe trajtuar në mënyrë dhe nivel adekuat, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelet komunale, përfshirë edhe Komunën e Prishtinës. Këtë më së miri e vërteton mungesa e gjatë e një ligji gjithëpërfshirës dhe, në veçanti, mungesa e Strategjisë Zhvillimore të Turizmit të Kosovës. Vendosja në procesin e hartimit të Strategjisë së Agroturizmit dhe ngritjes së kapaciteteve në nivelin komunal të Prishtinës, por edhe të disa komunave të tjera që tashmë i kanë miratuar strategjitë e tyre, shënon një hap përpara në kuptimin e drejtë të mundësive që ofron sektori i turizmit në zhvillimin ekonomik të komunave dhe të Kosovës në përgjithësi, rritjen e mundësive zhvillimore dhe punësimit në të gjitha destinacionet që do të zhvillohen, promovohen dhe funksionalizohen.

2. Fjalori i termave dhe Akronimet

- **Agroturizmi:** Përcaktuar nga Charline Dubois, turisti në fermë: Një "imazh i ngatërruar", ku një sërë produktesh dhe aktiviteteve të tregtuara, përmes të cilave një vizitor ka mundësinë të mësojë për veçoritë e të djave, agrikulturës dhe jetës rurale.
- **Marka:** Imazhi pamor dhe i shfaqur përmes rrëfimeve, i paraqitur nga një organizatë ose produkt, për të demonstruar atraktivitetin dhe vlerën e tij.
- **Bashkëpunimi:** Akti i kombinimit të përpjekjeve midis bizneseve dhe organizatave publike dhe/ose private, si dhe komunitetit lokal, duke punuar drejt një qëllimi të përbashkët ose kur interesat e përbashkëta mund të përmbushen në mënyrë më efektive duke punuar së bashku (qoftë përmes kohës dhe alokimit të burimeve financiare, përpjekjeve të marketingut, etj.).
- **Angazhimi i komunitetit:** Procesi i përfshirjes së banorëve, pronarëve të bizneseve lokale dhe të tjerëve, drejtpërdrejt në mbledhjen e informacionit dhe marrjen e vendimeve.
- **Gjeneruesi i kërkesës:** Çdo ngjarje, atraksion, akomodim, aktivitet, manifestim, festival apo iniciativë tjetër që mund të jetë motivuesi kryesor për udhëtimin e vizitorëve drejt një destinacioni.
- **Destinacioni:** Një vend që njerëzit e vizitojnë me qëllim për arsye ose qëllime specifike.
- **Përfshirja:** Akti i përfshirjes së njerëzve të të gjitha prejardhjeve kulturore, gjinore, aftësive fizike, moshave dhe grupeve të të ardhurave në çdo fazë të zhvillimit të turizmit, nga angazhimi i komunitetit deri te komisionet, marketingu dhe promovimi.
- **Itinerari:** Një rrugë ose udhëtim i planifikuar, që përshkruan një sekuençë të qartë aktiviteteve dhe orarën e sugjeruar.
- **Paketat:** Kur shumë ofrues shërbimesh veprojnë së bashku, duke siguruar një "produkt/eksperiencë" të paracaktuar. Për shembull: "Qëndroni për Fundjavë - Vizitoni Kosovën", paketa "Vizitoni Prishtinën", paketa e darkës, verërave dhe gastronomisë, paketa e ngjarjeve dhe qëndrimit, paketa e aktiviteteve dhe shujtave, etj.
- **Udhëtari i ndërgjegjshëm shoqëror:** Ata udhëtarë që kanë përparësi burimet etike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të argëtimit turistik.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit:** Një qasje ndaj rritjes dhe promovimit të turizmit që ka përparësi përfitimet afatgjata për banorët, pronarët e bizneseve dhe vizitorët; shpirti i komunitetit; respekt për të gjithë njerëzit dhe mjedisin natyror; dhe mjetet financiare të shpenzuara nga vizitorët.
- **Agroturizmi i qëndrueshëm:** Agroturizmi që nxit zhvillimin e qëndrueshëm rural, duke përfituar komunitetet rurale, rritur të ardhurat për punëtorët e bujqësisë dhe promovuar qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore.
- **Turizmi:** Shfrytëzimi i atraksioneve, resurseve natyrore, arteve, kulturës, tërheqjes së kuzhinës ose faktorëve të tjerë për të tërhequr shpenzimet e vizitorëve në çdo zonë të caktuar.
- **Asetët turistike / produkti turistik / shërbimi turistik:** Çdo ngjarje, atraksion, eksperiencë, shërbim apo aktivitet tjetër që mbështetet në ofrimin e të mirave nga turizmi.
- **VFR Vizita e miqve dhe të afërmeve (Visiting friends & relatives).**
- **Ekonomia e vizitorëve:** Përcaktuar nga Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit si çdo aktivitet ekonomik i drejtpërdrejtë, indirekt dhe i nxitur, që rezulton nga ndërveprimet e vizitorëve me destinacionin e tyre.

Aspektet qenësorë të Agroturizmit		
1.	Përvoja autentike	<ul style="list-style-type: none"> - Vizitorët mund të marrin pjesë në aktivitetet e përditshme bujqësore, si vjelja e frutave, mbjellja, kujdesi ndaj kafshëve dhe prodhimi i produkteve vendore. - Atyre u jepet mundësia të mësojnë për bujqësinë, traditat dhe kulturën vendase të mikpritësve.
2.	Akomodimi	<ul style="list-style-type: none"> - Akomodimi rural përfshin qëndrimin në ferma, në shtëpi fshatare ose në familje rurale që ofrojnë një ambient autentik dhe atmosferë të ngrohtë.
3.	Ushqimet dhe produktet lokale	<ul style="list-style-type: none"> - Turistët kanë mundësinë të shijojnë kuzhinën, produktet dhe specialitetet e gastronomisë lokale dhe vendore. - Degustimi i verërave vendase, djathërave, mjaltit dhe produkteve të tjera lokale është shpesh pjesë e ofertave të Agroturizmit.
4.	Veprimtaritë edukative	<ul style="list-style-type: none"> - Turet edukative dhe seminarët mbi teknikat bujqësore, ruajtjen e natyrës, zejet tradicionale dhe kulturën lokale. - Aktivitete për fëmijë dhe të rritur që përfshijnë të mësuarit përmes lojës dhe punës.
5.	Aktivitete rekreative	<ul style="list-style-type: none"> - Hiking, çiklizëm, kalërim, peshkim, kamping dhe aktivitete të tjera në natyrë që lejojnë turistët të shijojnë mjedisin natyror. - Ture dhe ekskursionet të organizuara nëpër zonat rurale të Gallapit dhe zonat e tjera rurale.
6.	Manifestimet kulturore	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në panairët e organizuara nga komuniteti lokal. Panairi ose panairi i komunitetit është një ngjarje e organizuar brenda komunitetit lokal, me qëllim të ofrimit të informacionit për një projekt dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet përkatëse.
Përfitimet nga Agroturizmi		
1.	Zhvillimi ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> - Kontributi në diversifikimin e të ardhurave të familjeve rurale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. - Nxitja e zhvillimit të bizneseve dhe zejeve lokale.
2.	Turizmi i qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së resurseve natyrore. - Agroturizmi inkurajon ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zejeve tradicionale.
3.	Mbajtja e popullsisë në vendbanimet e tyre në zonat rurale	<ul style="list-style-type: none"> - Reduktimi i migrimit të të rinjve nga zonat rurale, qoftë drejt zonave urbane apo jashtë vendit, duke u ofruar atyre mundësi ekonomike.
4.	Rritja e ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> - Edukimi i vizitorëve për rëndësinë e bujqësisë, ruajtjen e natyrës dhe stilit të jetesës së qëndrueshme në zonat rurale.
Elementet qenësorë të zhvillimit të Agroturizmit		
1.	Infrastruktura	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i infrastrukturës rurale, si rrugët, akomodimi, qendrat e vizitorëve, objektet sanitare dhe telekomunikacioni.
2.	Marketingu dhe promovimi	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i destinacioneve të Agroturizmit nëpërmjet mediave dixhitale, agjencive turistike, panaiereve dhe bashkëpunimit me komunitetet lokale.
3.	Trajnimi dhe edukimi	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnimet për fermerët dhe amvisëritë lokale për ofrimin e shërbimeve turistike, mikpritjen dhe marketingun.
4.	Partneritetet	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi me organizatat turistike, autoritetet vendore dhe institucionet e tjera përkatëse për promovimin dhe zhvillimin e Agroturizmit.
5.	Zhvillimi i qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i praktikave të turizmit të qëndrueshëm për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe efekte pozitive në komunitetet lokale dhe mjedisin.

Faktorët ose predispozitat e domosdoshme për zhvillimin e Agroturizmit

Zhvillimi i Agroturizmit, përveç atraksioneve natyrore dhe të trashëgimisë kulturo-historike, kërkon disa faktorë të domosdoshëm ose predispozita parësore, siç janë:

1. Banorët e përhershëm dhe stafi ndihmës i domosdoshëm në zonat rurale.
2. Aktivitetet e agrobiznesit, bazuar në aktivitetet bujqësore në hapësirat në pronësi ose të huazuara për afat të mesëm ose të gjatë.
3. Infrastruktura e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve bujqësore dhe për ruajtjen e produkteve.
4. Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mikpritjes dhe resurseve njerëzore.
5. Depozitimi dhe ruajtja e plehrave në vende adekuate dhe të sigurta, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së ambientit.
6. Infrastruktura publike: rrugët, sigurimi i ujit të pijshëm, kanalizimi dhe deponitë e përshtatshme.
7. Sigurimi i mjeteve për trafik të organizuar urban.
8. Qasje adekuate për të gjithë vizitorët, përfshirë familjet me fëmijë dhe personat me nevoja të veçanta.
9. Ekzistenca e resurseve njerëzore të përshtatshme për aktivitetet bujqësore, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të mikpritjes për vizitorët në ferma dhe struktura në destinacion.
10. Vullneti politik dhe gatishmëria institucionale për përkrahjen e investimeve dhe formave të tjera mbështetëse për aktivitetet bujqësore dhe Agroturizmin.

3. Hyrje

Kryeqyteti Prishtina ka një sipërfaqe rreth 572 km² dhe, bazuar në të dhënat e ASK-së nga regjistrimi i vitit 2024, komuna me më së shumti banorë në Kosovë është ajo e Prishtinës, me 227 mijë e 154 banorë. Rajoni Qendror i Prishtinës, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, arrin shifrën e 507,443 banorëve.

Prishtina, përveçse është kryeqytet, njëkohësisht është edhe qyteti më i madh në Republikën e Kosovës dhe shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, afër maleve të Gallapit (Gollakut). Distanca mes Shkupit dhe Prishtinës është 90 km, me Tiranën është 250 km dhe 300 km me Podgoricën.

Kryeqyteti është i pasur me atraksione dhe vlera të trashëgimisë kulturore dhe historike, ndërsa zonat rurale, kryesisht me konfiguracion kodrinoro-malore, kanë pasuri të jashtëzakonshme të resurseve natyrore. Agroturizmi ka një potencial të madh zhvillimi ekonomik dhe njihet si një industri e re zhvillimore. Në kryeqytet, përveç pjesës urbane, ku shtrihet trashëgimia kulturore dhe historike dhe gastronomia, rajoni i Prishtinës posedon potenciale dhe resurse të rëndësishme për Agroturizmin, turizmin rural, malor dhe ekoturizmin. Me kalimin e kohës, kryeqyteti ka identifikuar dhe njohur potencialin zhvillimor të Agroturizmit, si një mundësi për të nxitur ekonominë lokale. Qëndrimet në ferma bujqësore dhe përvojat "nga ferma në tavolinë" janë bërë të njohura, pasi Prishtina është destinacioni më i kërkuar nga turistët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Shpirti dinamik i kryeqytetit dhe veçantitë natyrore të zonave rurale dhe fshatrave përreth e bëjnë atë një nga destinacionet kryesore të turizmit në vend, me një potencial të madh zhvillimi ekonomik. Agroturizmi është ende në fazat e para të zhvillimit, ndërsa me këtë strategji synohet t'i jepet drejtimi dhe orientimi i duhur për zhvillim.

Zhvillimi ekonomik është një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës dhe komunave si nivel i dytë i pushtetit, ku turizmi dhe industria turistike, me nëndegët e saj: turizmi dhe udhëtimet, mikpritja hoteliere dhe gastronomia, duhet të jenë ndër prioritetet kryesore, duke marrë parasysh potencialet e trashëgimisë natyrore, kulturore-historike dhe resurset cilësore njerëzore që disponon Kosova dhe komunat veç e veç.

Bazuar në begatinë e theksuar të potencialeve dhe resurseve turistike në kushtet e vendit tonë dhe Rajonit të Komunës së Prishtinës, turizmi duhet të jetë ndër prioritetet zhvillimore, duke e vlerësuar dhe trajtuar si një ndër sektorët më të favorshëm për investime, veçanërisht për mundësitë e mëdha të investimeve nga diaspora, kur është fjala për Agroturizmin, turizmin malor dhe format e tjera të turizmit.

Komuna e Prishtinës, përmes realizimit të kësaj strategjie, synon ta përmirësojë imazhin e saj turistik, me moto-n: **"Qëndroni në Kosovë - Vizitoni Rajonin e Prishtinës"**.

Procesi i hartimit të draft-strategjisë së Rajonit Turistik të Prishtinës

Gjatë procesit të hartimit, vëmendje e veçantë duhet kushtuar fushave si në vijim:

- **Hulumtimi i tregut** – Bazuar në vlerësimet preliminare, nga tregjet më të rëndësishme emitive, destinacioni turistik i Prishtinës llogarit një treg potencial prej 350,000 vizitorësh ose mysafirësh gjatë një viti. Në kuadër të hulumtimit të tregut të kërkesës, në mungesë të Organizatës së Menaxhimit të destinacionit, është e nevojshme të intervistohen disa nga bizneset kryesore të industrisë së turizmit nga Prishtina, si dhe biznese dhe familjarë nga zonat rurale të Prishtinës, veçanërisht të konkurrencës në zonat e afërme, duke vlerësuar gjithashtu trendët dhe arritjet në nivel vendi.

- *Shembuj të praktikave më të mira* – Si në qasjen preliminare, ashtu edhe në fazat e tjera, është marrë parasysh një gamë e gjerë shembujsh nga praktikat më të mira, si një mjet shumë i dobishëm për të përcaktuar aktivitetet e konkurrentëve, veçanërisht në fushën e marketingut dixhital. Gjatë fazës preliminare, janë konsultuar përvojat e Gjermanisë dhe Kroacisë, ndonëse janë shikuar edhe përvoja të tjera relevante në nivel rajonal dhe evropian.
- *Përfshirja e industrisë së turizmit* – Si në fazën preliminare, ashtu edhe gjatë hartimit të draftit të parë, gjithashtu gjatë fazës së finalizimit të draftit të strategjisë, në kontaktet dhe vizitat enkas janë zhvilluar biseda këshilluese me përfaqësues të industrisë turistike, si mjet për të kontribuar në vendosjen e qëllimeve dhe objektivave të strategjisë, në zgjedhjen e strategjive të marketingut, si dhe në organizimin e nismave (shembull: Themelimi i DMO-së së Rajonit të Komunës së Prishtinës, etj.), të propozuara në kuadër të strategjisë.

Aktivitetet dhe veprimet janë hartuar në mënyrë strategjike për të siguruar që rajoni, fillimisht, përmes parashikimeve dhe rekomandimeve nga një studim i fizibilitetit, të orientohet në investimin për krijimin e një baze solide për rritjen e turizmit përmes zhvillimit të markës, përmirësimit të produktit dhe trajnimeve për gatishmërinë ndaj tregut pritës vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë diasporën. Pasi këto elemente thelbësore të jenë vendosur për të siguruar ofrimin pozitiv të shërbimeve turistike, fokusi mund të zhvendoset tërësisht në iniciativat e marketingut dhe përpjekjet promovuese. Duhet caktuar afate kohore të përgjithshme për secilin veprim për hir të zbatimit efektiv. Gjithashtu, përmes bashkërendimit të politikave favorizuese me sektorët e Qeverisë së Kosovës, duhet angazhuar në përkrahje të aktiviteteve investicionale, fillimisht në kuadër të bazës zhvillimore të bujqësisë, si aktivitet primar, dhe gjithashtu në ndërtimin dhe aktualizimin e strukturave dhe përmbajtjeve turistike, si dhe infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me kërkesat e vizitorëve dhe mysafirëve nga tregjet emitive.

Vizioni që kjo strategji planifikon të arrijë gjatë pesëvjeçarit vijues:

“Në vitin 2029, Rajoni i Prishtinës Kryeqytet do të promovohet dhe përjetohet si një destinacion atraktiv i turizmit në përgjithësi dhe agroturizmit në veçanti, që lidh njerëzit me tokën përmes natyrës, bujqësisë dhe zhvillimit të integruar rural; përmes arteve, kulturës, historisë dhe trashëgimisë; me njëri-tjetrin dhe me veten e tyre, përmes përvojave skenike, sportit dhe rekreacionit, wellness-it dhe shëndetit.”

4. Metodologjia dhe Struktura

Në zhvillimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimi të Turizmit, fazat dhe veprimet kryesore që janë realizuar përfshijnë:

4.1. Fazat kryesore të Hartimit të Strategjisë

Konsultimi i Referencave profesionale dhe bazimi në dokumentacionin planifikues në nivel komunal dhe qendror:

Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022.

- Draft Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2024-2028.
- Komuna e Prishtinës, Drejtorja e Zhvillimit Rural, Sektori i Bujqësisë, Listat e Fermerëve përfitues të përkrahjes, 2022; 2023; 2024.
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 - 2028, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Programi Nacional për Zhvillimin Nacional Lokal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, Qeveria e Kosovës, Zyra për Planifikim Strategjik.
- Strategjia afatmesme për bujqësi dhe zhvillim rural për Komunën e Prishtinës 2019-2023 (Draft).
- Plani Zhvillimor Urban – Prishtina 2012 – 2022.
- Plani zhvillimor komunal i Prishtinës 2012-2022.
- Gollak region Master Plan 2024; Swiss contact PPSE. (Plani Master i Rajonit të Gollakut 2024; Swisscontact PPSE)
- Propozim profesional për ri kategorizimin e Parkut Regjional Natyror “Gërmia” në kategorinë Peizazh i Mbrojtur, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
- Qyteti i Prishtinës.
- Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër, Komuna e Prishtinës, gusht 2021.
- Historia e qytetit të Prishtinës dhe kultura materiale, Qazim Namani.
- Parku i Natyrës “Gërmia”, Krenaria e Kryeqytetit, Ylber Sherifi, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
- Studimi Fizibilitetit: “Projekti i Zhvillimit Lokal – Rajoni i Pejës”, Zhvillimi i Turizmit mbi Trashëgiminë Kulturore; viti 2011 Zyra e Këshillit të Evropës.
- Zhvillimi i Turizmit të Përgjegjshëm – Turizmi i Butë në Kosovë, në fokus Rajoni i Deçanit, viti 2021 EUSR Zyra e Përfaqësuesit Special të Unionit Evropian.
- Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm në Kosovë, në fokus Brezovica dhe Bjeshkët e Sharrit, viti 2022, EUSR Zyra e Përfaqësuesit Special të Unionit Evropian.
- Mundësitë e Zhvillimit të Turizmit Rural në Kosovë (Përvojat Gjermane), Udhëzime për qiradhënësit privat, GHH Consult GMBH, Dr. Hank-Haase & Co.
- Strategjia razvoja održivog turizma do 2030. Godine, Hrvatski Sabor, Zagreb 2022. (Strategjia e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm deri në vitin 2030, Kuvendi Kroat, Zagreb 2022)
- Investimet përmes Partneritetit Publiko-Privat (PPP) në Kosovë dhe rruga përpara, GAP Institute 2024.
- The Food and Agriculture Organization (FAO) and various agroecological scholars: Several key principles that guide agroecological practices.

(Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe studiues të ndryshëm të agroekologjisë: Parimet kryesore që udhëheqin praktikën agroekologjike.

- Agroecology, GIZ.
(Agroekologjia, GIZ).

Angazhimi i palëve të interesuara:

- Intervista dhe stuhitë mendimesh me palët e interesuara lidhur me potencialet dhe resurset turistike në nivel vendi dhe në rajonin e Prishtinës, përfshirë resurset natyrore, kulturore-historike dhe ato njerëzore.
- Intervista dhe biseda kokë më kokë në nivel të udhëheqësve të sektorëve të relevancës turistike dhe zhvillimit të integruar rural, në kuadër të Komunës së Prishtinës.
- Punëtori me rastin e prezantimit të draftit paraprak me përfaqësues të komunës dhe palëve të tjera të interesuara.
- Identifikimi i resurseve primare turistike, natyrore, kulturore-historike dhe njerëzore, veçanërisht resurseve për zhvillimin e agroturizmit, në nivel të Kosovës dhe rajonit të Prishtinës.
- Prezantimi dhe diskutimi i "Udhëzuesit të markës së Rajonit të Prishtinës: 'Qëndroni në Kosovë - Vizitoni Rajonin e Prishtinës'".

Qëllimet e aktiviteteve të kombinuara, për të kuptuar dhe realizuar:

- Vlerësimin e nivelit ekzistues rreth turizmit në kuadër të Rajonit Turistik Qendror të Prishtinës, analiza krahasuese nga një zonë në tjetrën dhe dallimet mes tyre.
- Perceptimi i mundësive për zhvillimin e turizmit, agroturizmit në veçanti.
- Vlerësimin e boshllëqeve dhe mangësive të destinacionit në cilësinë dhe përmbajtjen e produktit dhe infrastrukturës, në raport me kërkesat e segmenteve të tregut turistik, lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë diasporën.

4.2. Vlerësimi i gjendjes së Turizmit në Kosovë dhe Komunën e Prishtinës

Kosova, ndonëse një vend relativisht i vogël me sipërfaqe prej 10,905.25 km², ka një trashëgimi të pasur dhe të diversifikuar natyrore, si dhe aspekte dinamike dhe unike të Trashëgimisë Kulturo-Historike. Me një popullatë të re, të shkolluar dhe të edukuar në parimet e mikpritjes tradicionale dhe profesionale, vendi posedon potenciale dhe resurse të jashtëzakonshme për zhvillimin e sektorit të turizmit dhe mikpritjes hoteliere.

Pavarësisht se Kosova nuk ka det, ajo ofron një gamë të pasur vlerash dhe resursesh për turizmin kulturor, urban, malor, si dhe për turizmin rekreativ, sportiv dhe shëndetësor. Falë burimeve natyrore dhe kulturo-historike, jashtë qendrave urbane, Kosova dhe Komuna e Prishtinës kanë të gjitha atributet dhe parakushtet për zhvillimin e turizmit të komunitetit lokal, përfshirë agroturizmin dhe turizmin rural.

4.3. Një përmbledhje e shkurtër e zhvillimit të turizmit në Kosovë

Kosova, si destinacion turistik, ende nuk është hulumtuar sa duhet. Me qindra kilometra vargmale, male dhe shtigje malore të pafundme, lumenj të vrullshëm dhe liqene të qetë, qindra fshatra piktoreskë, zakone dhe tradita të panumërta, arte dhe artizanate tërheqëse tradicionale dhe gastronomi tradicionale, bazuar në antikitetet dhe produkte të pastra natyrore të dhuruara nga toka pjellore e

Kosovës, vendi mirëpret ngrohtësisht vizitorë individualë, grupe të vogla dhe grupe të organizuara turistësh. Natyra, kultura dhe tradita këtu janë të pashembullta dhe unike, por relativisht të paprekura.

Zhvillimi i turizmit dhe mikpritjes hoteliere në Kosovë, bazuar në kohën dhe rrethanat historike, mund të konsiderohet të ketë kaluar në tri periudha të lëvizjeve ciklike dhe shumë kontradiktore: degradim dhe shkatërrim gjatë periudhës së dytë, në vitet '90, si dhe ndryshime dramatike pozitive në periudhën e tretë.

4.4. Niveli i arritur i Zhvillimit të Turizmit në Kosovë

Në mungesë të planeve strategjike dhe orientimeve të duhura zhvillimore në të gjitha nivelet, sektori i turizmit në periudhën e pasluftës ka shënuar një fillim zhvillimi relativisht të paplanifikuar dhe të pa orientuar, me përqendrim të numrit më të madh të kapaciteteve akomoduese jashtë atraksioneve dhe qendrave urbane.

Rezultate relativisht të mira në industrinë e turizmit dhe mikpritjes hoteliere arritën disa biznese private falë nismave të tyre, duke kaluar nëpër sfida të shumta dhe pa mirëkuptim ose mbështetje nga institucionet qendrore. Edhe në sektorin e arsimit, kishte përpjekje dhe eksperimente për të përmirësuar arsimin profesional, fillimisht në nivelin parauniversitar dhe më pas në nivelin universitar. Më në fund, kurrikulat e reja të arsimit dual profesional, të përgatitura dhe të bazuara në përvojat më të mira nga Gjermania, Zvicra dhe Austria, kanë filluar të zbatohen në shkollat profesionale të Kosovës dhe Prishtinës.

Në nivelin qendror institucional, turizmi dhe mikpritja fillimisht iu shtuan Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në fillim si Departament për Turizmin, por më vonë u reduktuan në nivelin e një divizioni, me interes të ulët buxhetor dhe me burime të kufizuara njerëzore profesionale.

Përveç Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përgjegjëse për zhvillimin e turizmit janë të paktën katër ministri të tjera që ndikojnë në zhvillimin e turizmit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Megjithatë këto ministri kanë autorizimin, burimet financiare dhe përgjegjësinë për të punuar ngushtë me ministrinë përgjegjëse dhe organet e tyre, për shkak të mungesës së vullnetit politik, njohurive dhe ndërgjegjësimit, aktualisht nuk ekziston një bashkëpunim adekuat ndërministror. Një bashkëpunim i tillë është shumë i nevojshëm për programet e përbashkëta të zhvillimit të turizmit, veçanërisht për turizmin e qëndrueshëm dhe turizmin me bazë në komunitetin lokal (eko, agro dhe turizmin rural).

4.5. Faktorët e ngecjes së zhvillimit të turizmit në Kosovë me fokus Prishtinën

Situata e pafavorshme e bizneseve të turizmit dhe mikpritjes Hoteliere në Kosovë
<ul style="list-style-type: none">• Investime të konsiderueshme shumë të shtrenjta në infrastrukturën hoteliere dhe gastronominë,• Mungesa ekstreme e planifikimit dhe koordinimit profesional,• Mungesa ekstreme e menaxhimit profesional,• Mungesë e theksuar e arsimit dhe aftësisë profesionale,• Qasja e gabuar dhe gulfatëse e institucioneve në të gjitha nivelet,• Politikat e pafavorshme të turizmit në të gjitha nivelet,• Injorimi i kërkesave dhe shqetësimeve të biznesit nga institucionet,• Mungesë e theksuar e mbështetjes me investimet në infrastrukturë,• Ndonjëherë, orientime të gabuara dhe jo konsistente të mbështetjes së donatorëve, për shkak të koordinimit joprofesional të aktiviteteve të tyre, nga institucionet e Kosovës dhe ato komunale,

- Politika të pafavorshme dhe qasje e vështirë për hua të favorshme,
- Mungesa e investimeve të huaja, për shkak të procedurave të komplikuara, burokracisë së rëndë dhe rastet e shantazhimit të investitorëve të mundshëm dhe të interesuar.
- Neglizhimi i turizmit si sektor, në nivelin organizativ, kadrovik dhe buxhetor, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelet komunale.

4.6. Ndikimi i krizave në turizëm dhe ndryshimet në sjelljen dhe nevojat e turistëve

- Dy dekadat e fundit janë shënuar nga një sërë krizash dhe tronditjesh globale e rajonale të llojeve të ndryshme (klimatike, gjeopolitike, financiare, shëndetësore, konflikte në nivel global dhe ndikime në rajonin e Kosovës dhe më gjerë).
- Pandemia e COVID-19 vuri në dukje rreziqet dhe dëmet e mëdha të turizmit kosovar, me rënie drastike në të gjithë parametrat përkatës (numri i arritjeve, numri i vizitorëve, netëqëndrimet, struktura e shpenzimeve turistike, të hyrat) gjatë viteve 2020 dhe 2021, me vazhdim të ndikimit edhe në pjesën e parë të vitit 2022. Kjo tregoi nevojën për planifikim proaktiv në mënyrë që të rritet elasticiteti i destinacionit në rast të situatave të reja krize.
- Krizat shkaktojnë ndryshime në nivelin e të gjithë sistemit të kërkesës dhe ofertës së turizmit, dhe mungesa e një modeli të përshtatshëm menaxhimi zvogëlon mundësinë e një reagimi dhe përshtatjeje të suksesshme ndaj ndryshimeve.
- Ka një ndryshim të rëndësishëm edhe në sjelljen e turistëve, të cilët tregojnë një interesim në rritje për të qenë në natyrë, sidomos në meset e komunitetit lokal, ku mund të përfshihen në aktivitete në natyrë dhe mundësinë e angazhimit në aktivitetet familjare. Kjo, në njërin anë, mundëson orientimin e investimeve në këtë drejtim, por mund të rezultojë edhe në ngarkesa më të mëdha në zonat natyrore, veçanërisht në zonat e mbrojtura të natyrës.

4.7. Rëndësia e zhvillimit të turizmit në Kosovë

Zhvillimi i Turizmit në Kosovë duhet të jetë në kreun e prioriteteve Institucionale

- Shfrytëzimi dhe përdorimi ekonomik i resurseve të pasura natyrore.
- Përdorimi i resurseve natyrore dhe kulturore në mënyrë të ripërtitshme (shijimi i peizazheve, bukurive natyrore, lumenjve malorë dhe liqeneve të qetë, florës dhe faunës, turët nëpër qytete dhe zonat malore, si dhe mjediset rurale).
- Promovimi vendor dhe ndërkombëtar i trashëgimisë së pasur kulturore.
- Promovimi i investimeve të huaja dhe të brendshme direkte në fushën e turizmit dhe rekreacionit.
- Rritje e konsiderueshme e punësimit, në përgjithësi, dhe veçanërisht e grave dhe të rinjve.
- Stimulimi i iniciativës ekonomike private, individuale dhe familjare, përmes turizmit me bazë në komunitet dhe iniciativës familjare, siç është agroturizmi, si një formë efektive për zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin e përshtetshëm të ekonomisë familjare.
- Forcimi i sektorit të eksportit dhe përmirësimi i ndjeshëm i bilancit tregtar me vendet e huaja.
- Zhvillimi rajonal më i ekuilibruar në nivel kombëtar.

Përveç të gjitha sfidave dhe mungesës së mirëkuptimit dhe mbështetjes institucionale, ne duhet të deklarojmë dhe promovojmë gjerësisht ndikimet ekonomike të industrisë së Turizmit në Kosovë, së bashku me ndikimet sociale dhe mjedisore. Çdo vit në Kosovë, përfituesit e mëposhtëm përfitojnë nga sektori i turizmit.

Përfituesit nga Turizmi dhe Mikpritja Hoteliere në Kosovë dhe Rajonin e Prishtinës

<ul style="list-style-type: none"> • Një numër i madh i të punësuarve, si dhe familjet e tyre • Përfitimet e të gjithë sektorëve tjerë ekonomikë nga turizmi: 	
- Tregtimi i mallrave të konsumit	- Sektori i ndërtimit
- Tregtimi i artikujve ushqimorë dhe pijeve	- Transporti
- Bujqësia, blegtoria, bletaria, peshkataria, etj.	- Arti dhe Zejtari të Tradicionale
- Industria e ushqimit dhe pijeve	- Zanatet
- Tregtimi i Karburanteve	- Komuniteti lokal dhe familjet e tyre
- Industria ushqimore	- Komuniteti kulturor
- Buxheti i Kosovës, taksat komunale, etj.	- Komuniteti fetar, etj.

4.8. Partneriteti publik dhe privat

Qëllimet, synimet dhe përfitimet nga turizmi për shoqërinë mund të bëhen të njohura nëse institucionet e sektorit publik (qeveria, administrata, administrata lokale) dhe subjektet afariste të sektorit privat (pronarët e objekteve hoteliere, të mjeteve të transportit dhe të agjencive turistike, të objekteve artizanale, të objekteve të banimit në zonat rurale dhe malore etj.) koordinojnë aftësitë e tyre kreative dhe përpjekjet për realizimin e një strategjie të përbashkët turistike. Me qëllim të arritjes së këtij objekti, institucionet ekzistuese publike dhe ato private duhet të bashkëpunojnë për zhvillimin e bazës dhe të resurseve turistike.

4.9. Rajonet Turistike të Kosovës

Duke marrë parasysh aspektet gjeofizike, administrative, komunikative dhe të shtrirjes rajonale, në vitin 2006, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pati marrë vendim që Kosova të ndahet në pesë rajone turistike:

1. Rajoni turistik qendror i Prishtinës;
2. Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna;
3. Rajoni turistik i Sharrit;
4. Rajoni turistik i Ana Moravës;
5. Rajoni turistik i Mitrovicës.

Figura 1. Pesë Rajonet turistike të Kosovës



4.10.Rajoni turistik Qendror i Prishtinës

Në rajonin turistik të Prishtinës (komunat: Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi), ekzistojnë potenciale cilësore, të cilat megjithatë dallojnë mjaft nga ato të Sharrit dhe të Bjeshkëve të Nemuna.

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, është qyteti kryesor në këtë rajon turistik. Komuna e Prishtinës dhe vetë qyteti i Prishtinës janë rajoni më i vizituar, me numrin e arritjeve dhe netëve të qëndrimit të turistëve ndërkombëtarë, rajonalë dhe nga diaspora ose mërgata. Prishtina është qendër e turizmit urban, atij kulturor, të gastronomisë dhe biznesit vendor dhe rajonal. Prishtina, rrethina dhe rajoni i Komunës së Prishtinës janë të pasura me monumente të trashëgimisë kulturore-historike. Po ashtu, zonat kodrinore malore të Gallapit/Gollakut, por edhe të tjera përreth Prishtinës, janë vende mjaft të përshtatshme ku në të ardhmen mund të zhvillohen disa lloje të turizmit, si aktivitete në natyrë, agroturizëm, turizëm rural, turizëm shëndetësor, etj.

Llojet prioritare të produktit turistik në rajonin qendror të Prishtinës janë:

- Turizmi kulturor;
- Turizmi Urban;
- Turizmi malor dhe aktiviteteve në Natyrë;
- Agroturizmi;
- Turizmi rural;
- Turizmi shëndetësor.

4.11.Disa të dhëna bazë të statistikave lidhur me Turizmin në Kosovë dhe Rajonin e Prishtinës

Përkundër disa përmirësimeve të fundit në lidhje me statistikën turistike, ka ende boshllëqe dhe dyshime mbi të dhënat reale dhe të bazuara në lidhje me kapacitetet akomoduese, arritjet e turistëve dhe "kush" janë turistë të vërtetë ndërkombëtarë, të cilat nuk bazohen në mënyrë adekuate në Përkufizimin dhe Statistikat e Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO). Natyrisht, statistikën joadekuate po e përjashtojnë Diasporën e Kosovës nga grupi i turistëve ndërkombëtarë, duke i konsideruar ata gabimisht si qytetarë të zakonshëm kosovarë, pa marrë parasysh se vendbanimi i tyre i përhershëm është në vende të ndryshme evropiane dhe tej oqeanike.

Në fakt, vizitorët e Diasporës janë të përjashtuar edhe në statistika të tjera, si fjetjet, shpenzimet turistike në hotele/motele, restorante, transport turistik, shoppingun turistik, transportin e brendshëm, shpenzime të mëdha për ngjarje familjare dhe ahengje dasmash, etj. Sipas disa analizave dhe vlerësimeve profesionale, përfshirja e Diasporës së Kosovës dhe kontributi i tyre i drejtpërdrejtë në grupin e turistëve/vizitorëve ndërkombëtarë, përveç remitencave, do të ndryshojë të gjithë qasjen dhe vlerësimin real të arritjeve dhe shpenzimeve turistike ndërkombëtare.

4.12.Kapacitetet akomoduese turistike në Kosovë dhe Prishtinë, sipas llojit të akomodimit

Bazuar në të dhënat nga Agjencia e Statistikave, Kosova ka mbi 11,800 shtretër për akomodim të mysafirëve, me 7,551 dhoma, të cilat janë shpërndarë në 499 njësi akomoduese. Numri më i madh i njësisë akomoduese u takon hoteleve, me 240 njësi, dhe 180 motele, ndërsa të tjerat përfshijnë bujtina dhe hostele.

Tabela 1. Numri i njësive akomoduese, dhomave dhe shtretërve sipas destinacioneve ose qendrave rajonale

Qendrat rajonale	2022			2021			2020		
	Njësi	Dhoma	Shtretër	Njësi	Dhoma	Shtretër	Njësi	Dhoma	Shtretër
Prishtina	161	2 785	3 791	161	2 785	3 791	160	2 778	3 765
Kosova	499	7 551	11 811	499	7 551	11 811	490	7 368	11 572

Burimi: Statistikat e hoteleve ASK 2023

Tabela 2. Numri i vizitorëve sipas Rajoneve turistike ose destinacioneve të qendrave rajonale

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Prishtinë	27 076	57 569	49 172	46 636	68 537	68 687	77 167	89 050	109 400	107 691	114 071	122 541	55 783	134 362	190 947
Kosovë	44 294	88 949	79 045	72 393	98 763	95 454	107 790	139 438	257 422	251 290	300 803	287 083	148 543	355 141	460 467

Burimi: Statistikat e hoteleve ASK 2023

Tabela 3. Numri i netëqëndrimit sipas Rajoneve turistike ose destinacioneve qendrave rajonale

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Prishtinë	50 198	92 245	83 694	80 620	102 846	102 323	114 489	130 269	169 237	162 954	183 843	213 700	101 582	220 661	322 446
Kosovë	69 512	130 918	121 517	110 341	142 976	138 750	157 340	202 041	400 068	397 469	476 446	490 401	261 420	580 203	818 832

Burimi: Statistikat e hoteleve ASK 2023

Prishtina është rajoni që ka numrin më të madh të njësive, shtretërve dhe dhomave në dispozicion për akomodim turistik. Pas Prishtinës, ndjek Prizreni dhe Peja, me kapacitetet e disponueshme për akomodimin e turistëve. Sipas vlerësimeve, Kosova ka rreth 1 shtrat për 1 km² dhe 0.006 shtretër për frymë.

4.13. Karakteristikat e përgjithshme të Destinacionit Turistik rajoni i komunës së Prishtinës

Për shkak të pozitës gjeografike dhe pozicionimit rreth Kryeqendrës së Prishtinës, për dallim nga e kaluara, kur një numër i konsideruar punonin në tregti dhe kompanitë e mëdha dhe të mesme të energjetikës dhe industrisë, në pronësi publike, aktualisht, komuniteti në Rajonin e Komunës së Prishtinës është më së shumti i orientuar në ndërtimtari, pemëtari dhe perimtari, blegtori dhe aktivitete të pakta bujqësore, si dhe në tregti dhe gastronomi. Pjesa më e madhe e pronave të tokës janë sipërfaqe kodrinore malore dhe kullota të mira. Gjersa në rajonet e rrafshëta dhe lugina, një pjesë e madhe e tokës së dikurshme pjellore, tani janë zënë me ndërtime të ndryshme, duke humbur interesin dhe mundësinë e vazhdimin të aktiviteteve bujqësore.

Komuniteti është relativisht i varfër dhe mundësitë për punësim janë të orientuara primare në blegtori dhe pemëtari, si dhe në aktivitete të tjera bujqësore. Komuniteti në destinacion dhe në zonën më të gjerë të rajonit të skajshëm kodrinor – malor të Gallapit, për shkak të pozicionit gjeografik, është zonë e pazhvilluar dhe ekonomikisht pasive, në varësi të produkteve të veta bujqësore, më shumë të segmenteve të pemëtarisë dhe perimtarisë, dhe fermave të gjedhëve dhe shpezërisë, si dhe furnizimit nga njësitë e vogla tregtare ekzistuese. Për shkaqe ekonomike dhe mundësive të pamjaftueshme të punësimit, një pjesë e madhe e komunitetit lokal është zhvendosur në Prishtinë dhe qytetet tjera, si dhe kanë emigruar jashtë vendit, kryesisht në vendet evropiane. Madje, një numër i komunitetit biznesor lokal, të angazhuar në aktivitete bujqësore, ferma, plantacione dhe kopshtije të perimeve, për shkak të mundësive të vogla zhvillimore, por edhe krizave shëndetësore dhe ekonomike, kanë zvogëluar dukshëm kapacitetet në gjendje të mbijetesës, në pritje të mundësive dhe përkrahjes nga institucionet e Kosovës dhe ato komunale.

Duke jetuar në rrethana të vështira ekonomike dhe sociale për shumë dekada, të lënë pas dore nga të gjitha regjimet e mëparshme, popullsia e kësaj zone u detyrua të emigronte vazhdimisht, qoftë në Prishtinë, brenda Kosovës apo jashtë saj. Prandaj, shumica e familjeve kanë të paktën një ose më shumë anëtarë që punojnë dhe jetojnë në vende jashtë Kosovës.

Në këto rrethana, financimi dhe burimet bazë për jetesë janë remitancat e diasporës dhe aktivitetet e tyre modeste rurale dhe të varfëra shtëpiake. Presioni afatgjatë i regjimeve, për t'i mbajtur ato të pazhvilluara (edhe sipas standardeve të Kosovës), si dhe shkatërrimet e mëdha të luftës së fundit, kanë ndikuar negativisht në standardin e jetesës. Megjithatë, pas përfundimit të Luftës në Kosovë, falë diasporës së shumtë dhe dërgesave të tyre të rregullta, rajoni u rikuperua relativisht shpejt, veçanërisht standardet e banimit dhe të ndërtimit dhe rinovimit të tij, duke qenë të lidhura fort emocionalisht me vendlindjen e tyre. Si pjesëtarët e diasporës ashtu edhe vendasit, që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të rajonit dhe evropian, dhe familjet e tyre në rajon, janë shumë të prirur për të ruajtur lidhjet me vendlindjen dhe pronat e tyre, duke synuar zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në vitet në vijim. Pjesëtarët e diasporës po shfrytëzojnë çdo rast dhe mundësi për të vizituar dhe kaluar pushimet dhe kohën e lirë në vendlindjen e tyre, duke menduar që në fazën e relaksimit të Pandemisë dhe krizës globale ekonomike, të orientohen në investimet në Atdhe.

Prania dhe ndihma e organizatave donatore ndërkombëtare, duke ndihmuar komunitetin me mbështetjen dhe zhvillimin e mirëfilltë të biznesit të vogël dhe të mesëm, ka ofruar ndihmë të rëndësishme, por ka nevojë për mbështetje më bizneset më orientime dhe qasje me qëndrueshmëri si synim parimor.

4.14. Raporti konkurrues i Destinacionit ndaj qendrave në rajonet tjera turistike të Kosovës

Rajoni i Komunës së Prishtinës, si destinacion, përfshirë Prishtinën Kryeqytet, radhitët ndër rajonet më të zhvilluara në aspektin e investimeve në strukturat turistike dhe të mikpritjes hoteliere, si dhe në gastronominë cilësore, falë ekskluzivisht investimeve individuale private dhe atyre nga diaspora. Ka munguar mjaft përkrahja institucionale, vendore dhe komunale e planifikimit, valorizimit dhe zhvillimit të industrisë turistike, si në Prishtinë ashtu edhe në Rajonin e Komunës së Prishtinës, përfshirë turizmin dhe udhëtimet, mikpritjen hoteliere dhe gastronominë, si dhe në format e turizmit të komunitetit lokal, përfshirë agroturizmin.

Këtë vlerësim preliminar e dëshmojnë sa ky sektor ishte prezent në planet zhvillimore të Prishtinës, ku fare pak janë përmendur dhe përfshirë, edhe atje, në mënyrë episodike, aspektet vlerësuese të potencialeve dhe resurseve turistike të Rajonit të Komunës. Sa i përket zhvillimit të turizmit të bazuar në komunitetin lokal, veçanërisht agroturizmit, problemi, mbase, qëndron në ngecjen zhvillimore ekonomike, në veçanti në sektorin tani gjithëpërfshirës privat, në sektorin e bujqësisë dhe agroturizmit,

krahasuar me rajonet dhe qendrat tjera të Kosovës. Shkaku kryesor është mungesa e iniciativave dhe aktiviteteve investive private dhe atyre në partneritetin publiko – privat. Kjo ndoshta edhe për shkak të traditës nga e kaluara, ku Prishtina është shquar për nivel të lartë të zhvillimit industrial, dhe ku shumica e popullsisë aktive është orientuar në sektorin industrial dhe energjetik publik, si dhe në shërbimet publike në kuadër të institucioneve të Kryeqytetit.

Mësa kemi parë dhe vlerësuar nga dokumentet e gjertanishme planifikuese dhe zhvillimore të Komunës së Prishtinës, sektorit të turizmit nuk i është kushtuar kujdes dhe nuk i është dhënë prioriteti i merituar, duke pasur parasysh dhe vlerësuar potencialet dhe resurset e jashtëzakonshme. Madje, edhe në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal 2012 – 2022, turizmi është përmendur shkarazi, vetëm sa për të thënë! Kurse në dokumentet tjera planifikuese gjithashtu mungon vlerësimi i potencialeve dhe mundësive zhvillimore. Megjithatë, në 2-3 vitet e fundit, kujdesi i rëndësishëm dhe i merituar nga Komuna e Prishtinës i është dhënë zhvillimit të turizmit kulturor dhe të manifestimeve kulturore dhe sportive.

Andaj, vendimi dhe kontraktimi i hartimit të “Strategjisë së Agroturizmit dhe ngritjes së kapaciteteve” është një hap i rëndësishëm i zhvillimit të segmentit të agroturizmit, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me rëndësi të zhvillimit të integruar rural, duke pasur si objektiv valorizimin e potencialeve dhe resurseve të jashtëzakonshme në zonat kodrinore malore të Gallapit/Gollakut dhe zonave tjera relevante të Rajonit të Komunës së Prishtinës.

4.15. Zhvillimet dinamike historike ndër shekuj deri në ditët e sotme në rajonin e Prishtinës

Territori i Komunës së Prishtinës ka ndryshuar disa herë në tri dekadat e fundit. Deri pas përfundimit të Luftës, në fakt deri në fillim të viteve të 2000-ta, territori dhe zonat e Graçanicës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës i takonin Komunës së Prishtinës. Këto tri njësi të pushtetit lokal, ose komunat e reja, u themeluan në kuadër të ndryshimeve kushtetuese, në emër të procesit të decentralizimit të pushtetit lokal dhe krijimit të komunave të reja. Të tri komunat u mëvetësuan në vitet e në dekadën e dytë të këtij shekulli.

Komuna e Prishtinës kishte më parë një numër të popullsisë dhe sipërfaqe shumë më të madhe. Kjo vështirëson krahasimin historik të të dhënave statistikore. Të dhënat e popullsisë nga dekadat e kaluara nuk thirren në sipërfaqet e njëjta, siç është rasti, p.sh., me të dhënat aktuale.

4.16. Prishtina Kryeqytet i Kosovës, ndër qytetet më të mëdha në rajon

Kryeqyteti Prishtina ka një sipërfaqe rreth 572 km² dhe, bazuar në të dhënat e ASK-së nga regjistrimet e vitit 2024, është komuna me numrin më të madh të banorëve në Kosovë, me 227,154 banorë. Rajoni i Qendror Turistik i Prishtinës, nga regjistrimi i popullsisë 2024, arrin shifrën e 507,443 banorëve. Prishtina, përveç se është kryeqytet, njëkohësisht është edhe qyteti më i madh në Republikën e Kosovës, dhe shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, afër maleve të Gallapit/Gollakut, ku distanca mes Shkupit dhe Prishtinës është 90 km, me Tiranën ka distancë 250 km, dhe 300 km me Podgoricën.

Kryeqyteti është i pasur me trashëgimi kulturore dhe historike. Ndërsa, agroturizmi ka një potencial të madh të zhvillimit ekonomik dhe njihet si një formë dhe mundësi e re zhvillimore e turizmit të komunitetit lokal dhe si një segment i rëndësishëm i zhvillimit të integruar rural. Në kryeqytet, përveç pjesës urbane, ku gjendet trashëgimia kulturore dhe historike, edhe në fshatrat e saj ekziston potencial i rëndësishëm dhe resurse të bollshme për zhvillimin e agroturizmit, turizmit rural, turizmit malor dhe ekoturizmit. Me kalimin e kohës, kryeqyteti ka njohur dhe ka vendosur në prioritet potencialin zhvillimor të agroturizmit, si një mënyrë për të nxitur ekonominë lokale. Qëndrimet në ferma bujqësore dhe përvojat nga ferma në tavolinë u bënë të njohura pasi që kryeqyteti Prishtina është destinacioni më i kërkuar nga turistët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Shpirti dinamik që e ofron Prishtina, si dhe veçantitë natyrore në fshatrat përreth, e bëjnë atë një nga destinacionet kryesore të turizmit në nivel vendi dhe me një potencial të madh të zhvillimit ekonomik. Agroturizmi është ende në fazat e para të zhvillimit, ndërsa me këtë strategji synohet t'i jepet kahje adekuatë zhvillimit. Prishtina është nyja më e rëndësishme e transportit të Kosovës, atij ajror, hekurudhor dhe rrugor. Aeroporti ndërkombëtar i qytetit është aeroporti më i madh i vendit dhe ndër më të mëdhenjtë në rajon. Një sërë autostradash, të tilla si R 6 dhe R 7, gravitojnë qytetin dhe e lidhin atë me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

4.17. Historiku i Prishtinës dhe Rajonit komunal

Territori i qytetit të Prishtinës ishte i banuar që para 7000 viteve. Gjatë punimeve të rastit në qytet janë hasur gjurmë të qytetërimit që nga kultura e neolitit të vjetër: Kompleksi i spitalit të Prishtinës, Glladnica te Graçanica. Kultura e neolitit të ri: te tjerretorja, Bërrnica, Matiqani.

Gjatë epokës paleolitike, ajo që sot është zona e Prishtinës u përfshi nga kultura e Vinçës. Gjurmët e para të banimit në territorin e Prishtinës datojnë që nga periudha e neolitit, rreth 6 mijë vjet më parë, ndërsa hulumtimet arkeologjike (Matiçan, Graçanicë, Tjerretorja, Ulpianë) dëshmojnë se jeta në këto territore nuk është ndërprerë asnjëherë deri sot. Në kohët e antikitetit klasik ishte selia ose shtëpia e fisit ilir të Dardanëve. Mbreti Bardhyli bashkoi fise të ndryshme në zonën e Prishtinës në shekullin e 4-të p.e.r, duke themeluar Mbretërinë Dardane. Trashëgimia e epokës klasike është ende e dukshme në qytet, veçanërisht e përfaqësuar nga qyteti antik i Ulpianës, i cili konsiderohej një nga qytetet romake më të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik.

Gjurmët e kulturës materiale të periudhës së bronzit: Fusha e Badocit, Bërrnica e Poshtme, Kolovica, Grashtica, Keqekolla. Periudha e hekurit: Badoc, Matiçan, Tauk-Bahçe, Shkolla normale. Periudha romake: Ulpiana, Grashtica, Siqeva, Keqekolla, Periudha Bizantine- mesjeta e hershme: Matiqani.

Gjatë sundimit romak, në afërsi të Prishtinës u ngrit qyteti i njohur Ulpiana (Urbus splendissima), që njihet si qendër e Dardanisë ilire. Pas rënies dhe braktisjes së Ulpianës, në veriperëndim të saj u ngrit dhe u zhvillua Prishtina. Ajo përmendet për herë të parë si fshat i pa fortifikuar nga Perandori Bizantin, Johan Aktakuzën, në vitin 1342. Zhvillimi i tregtisë dhe xehetarisë ndikuan në përparimin dhe zgjerimin e qytetit. Prishtina, si qendër ekonomike kishte edhe tregun e vet, ndërsa përmendet edhe si qendër e organizimit të lojërave me kalorës. Gjatë shekullit XIII-XIV Prishtina merr tipare urbane, kur bëhet qendër e rëndësishme xehetare dhe tregtare në rrugën Dubrovnik-Stamboll.

Nëpër qytetin e Prishtinës kanë kaluar shumë rrugë të rëndësishme, rrugët që vinin nga Bosnja, rruga Naissus-Lissus, nga Scupi etj.

Sipas Tabula Peutingeriana stacioni rrugor Viciano i rrugës Naissus-Lissus ka qenë ndërmjet fshatrave Uglar dhe Çagllavicë në afërsi të Prishtinës.

Diku rreth 7 km në jug-lindje të Prishtinës gjendet qyteti i madh antik Ulpiana. Perandori romak Trajan (Marcus Ulpius Traianus), i njohur për një program të gjerë ndërtimi, në mesin e të cilave lindi Ulpiana e famshme dardane!

Ulpiana është një nga katër qytetet më të njohura të Dardanisë. Rrënojat e saj janë gjetur 1.5 km në perëndim të qytezës së Graçanices. Qyteti ndodhet në rrugën kryesore nga Danubi për në Via Egnatia, si dhe në rrugët Nish-Lezhë, Nish-Stobi. Gërmimet e kryera këtu që nga vitet 1950, kanë zbuluar një vendbanim të gjerë të epokës së bronzit, periudhë kjo që shënon diferencimet e para etnike në Evropën Juglindore. Për më tepër, afërsia e qytetit me zona të rëndësishme minerare e bëri atë të popullarizuar në të gjithë Perandorinë Romake. Ulpiana u bë e njohur si qendër kishtare nga fillimi i shekullit të IV të erës sonë. Qyteti ishte ndoshta një nga qendrat më të shkatërruara nga ushtria gotike e udhëhequr nga Teodoriku (479 të erës sonë), si dhe nga tërmeti katastrofik i vitit 518. Në burimet relevante të kohës,

ndër qendrat e shkatërruara përmendet edhe Ulpiana, e cila do të rindërtohet tërësisht nga Justiniani I (527-565), perandor bizantin me origjinë dardane nga ky territor. Që nga kjo kohë qyteti është quajtur JUSTINIANA SECUNDA, nga rrënojat e së cilës, viteve të fundit, janë zbuluar njoftime të rëndësishme. Në mesin e tyre duhet përmendur një monument kulti (katedrale) me përmasa shumë të mëdha dhe në te, një mozaik që ruan edhe mbishkrimin DARDANIAE!

Si duket Ulpiana e rrënuar dhe e plaçkitur në mesjetën e hershme ia lëshon rëndësinë Prishtinës si lokalitet në afërsi të saj. Tokat pjellore në Fushën e Kosovës dhe trevat minerare në malësinë e Gallapit ndikuan në përparimin dhe zhvillimin e këtij vendbanimi.

Prishtina gjatë mesjetës u bë seli e rëndësishme. Para betejës së Kosovës Prishtina ishte bërë kryeqytet i provincës dhe si i tillë mbeti edhe shumë kohë pas kësaj beteje.

Përveç ndërtimeve në Prishtinë, në afërsi, mbi themelet e një kishe më të hershme paleokristiane, ndërtohet manastiri i Graçanices, si monument i kulturës me rëndësi të veçantë.

Gjatë pushtimit osman në Prishtinë vendoset selia e sanxhakut, ndërsa në vitin 1530 shënohet si kasaba dhe stacion i rëndësishëm i rrugës Selanik-Sarajevë. Gjatë shek. XVII-XVIII, Prishtina pati një zhvillim të ngadalshëm, për shkak të luftërave dhe zjarreve, që e dogjën disa herë, ndërsa në shek. XIX fillon rimëkëmbja e saj. Ajo merr funksione të rëndësishme si qendër tregtare, por edhe si qendër politike dhe administrative. Në vitin 1877 Prishtina bëhet qendër e vilajetit të Kosovës. Gjatë këtij shekulli u hapën disa konsullata të vendeve evropiane, si ajo e Francës, e Anglisë, e Austrisë etj. Mirëpo, me largimin e qendrës së vilajetit në Shkup në vitin 1888, Prishtina humbi rolin administrativ dhe politik që e kishte.

Gjatë mesjetës së vonë, në Prishtinë, kanë qëndruar dhe kanë shkruar shumë personalitete të njohura të kohës si; Johan Kontaguzeni, mbreti hungarez Vlladisllavi II, Pjetër Bogdani, Haxhi Kallfa, Evlia Çelebiu etj. Pjetër Bogdani me origjinë shqiptare, krye ipeshkvi i Shkupit dhe Sofjes i raporton Vatikanit që Prishtina kishte 3000 shtëpi. Evlia Çelebiu shkruante në atë kohë për 2600 shtëpi të mëdha dhe të bukura duke veçuar sarajin e Allaj Begut dhe pallatin e gjyqit, dy hamamet e mëdha, mikpritjen dhe kulturën qytetare. Në Prishtinë kishte 11 hane, ndër të cilët më i njohuri në atë kohë ishte hani i Haxhi Beut.

Prishtina e kishte edhe çarshinë e vjetër të mbuluar. Nga monumentet publike në Prishtinë, veçohet objekti ku është sot Muzeu i Kosovës, objekti ku është vendosur Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Hamami i Madh, Kulla e Sahatit, Kompleksi i Emin Gjikut etj. Nga objektet sakrale veçohet xhamia e Çarshisë, Xhamia e madhe, Xhamia e Jashar Pashës etj. Në Prishtinë ekziston Teqeja e Prishtinës dhe Kisha evangjeliste. Në periferi të Prishtinës, në fshatin Shkabaj ekziston tyrbja e vogël dhe në fshatin Mazgit është tyrbja e Sulltan Muratit. Prishtina u shkatërrua shumë gjatë luftës ballkanike, kur forcat serbe hynë në qytet.

Xhamia e çarshisë (Gurit) në Prishtinë, është ndërtuar në fund të shekullit XIV dhe fillim të shekullit XV. Këtë xhami e ndërtoi Sulltan Bajaziti në shenjë të fitores së forcave osmane kundër koalicionit ballkanik në vitin 1389. Ky objekt është ndër monumentet më të vjetra të kulturës. Xhamia gjendej mbi çarshinë e vjetër të mbuluar të Prishtinës, andaj edhe e mori emrin "Xhamia e Çarshisë".

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Prishtina u bë qendër administrative e Kosovës në vitin 1947, dhe u zhvillua me një dinamikë të shpejtë duke mos i ruajtur objektet tradicionale të periudhës osmane. Sot Prishtina si qytet urban i kësaj periudhe ka ndryshuar plotësisht, në përjashtim të disa rrugëve të ngushta, ku kanë mbetur disa ndërtesa të rralla me vlerë arkitektonike të periudhës osmane.

Prishtina, pas Luftës së Dytë Botërore, e fitoi funksionin e qytetit të rëndësishëm ekonomik dhe administrativo-politik, që i krijuan bazë materiale solide. Madhësia e qytetit matej me shkallën e inkuadrimit, numrin e kuadrove, specialistëve, shkencëtarëve, politikanëve dhe profesioneve të lira intelektuale.

Pas periudhës së errët të shovinizmit të pushtetit serb në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore, ndryshimeve, sidomos gjatë kohës së Rankoviçit, pas Mbledhjes së Brionëve dhe largimit të tij, bëhen ndryshime relativisht pozitive, shikuar në distancën kohore, ku në vitin 1968 Themelohet Universiteti i Prishtinës. Me ndryshimet Kushtetuese në vitin 1973, Kosova fiton statusin e Krahinës Autonome Socialiste, duke pësuar ngritje të përmbajtjes së pushtetit, krahasuar me periudhën e mëparshme, kurse në aspektin ekonomik, behën zhvillime mjaftë dinamike në ngrijën e kapaciteteve të reja në të gjithë sektorët ekonomik. Në këtë periudhë Prishtina Kryeqytet përjetoi një lulëzim ekonomik dhe social, ndonëse shumë më të ultë së qendrat tjera të ISH-YU. Lulëzimi ekonomik i Prishtinës u shoqërua edhe me zhvillim të suksesshëm kulturor.

Megjithatë, pas dekadës së viteve të 80-ta, dhe sjelljeve mjaftë destruktive të pushtetit serb, ndaj të gjitha republikave të Ish-YU, në veçanti ndaj Krahinës së Kosovës, sidomos me Abrogimin e Autonomisë dhe vendosjen e pushtetit okupues serb në Kosovë, Kosova pësoi në të gjithë aspektet politike, ekonomike, sociale dhe njerëzore, duke përjetuar tmerret e orkestruara nga pushteti okupues fashistoid serb.

Situata vazhdoi në vitet 1990, kur autonomia e Kosovës ishte de facto e kufizuar. Projektet e shumta investive u ndërpreën, të cilat u përpoqën ta sjellin metropolin e Kosovës ekonomikisht të dobët në një nivel me republikat e tjera. Jugosllavia. Përkundrazi, zbatohet administrimi i drejtpërdrejtë i autoriteteve serbe.

Pas një periudhe jashtëzakonisht shtypëse, dhe përpjekjeve gjithë popullorë të mbijetesës, në fund të viteve të 90, gjegjësisht në vitin 1997, në Prishtinë u zhvilluan demonstrata të mëdha studentore, si dhe filloj vetëmbrojtja gjithë popullore, që si rezultat solli ngritjen e njësiteve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat me ndihmën e popullatës, u përpoqën të qëndronin përballë forcave serbe në të gjitha rajonet e Kosovës.

Duke parë qëndrimin dhe përgjigjën gjithë popullore të Kosovës, forcat e organizuara të armikut, organizuar egzodin e paparë, duke ndjekur popullsinë nga trojet e tyre, nga të gjitha rajonet e Kosovës, përfshirë popullsinë e Kryeqytetit dhe zonave rurale, ku gjatë këtyre aksioneve spastruese vranë e djegën, plaçkitën dhe djegën çdo gjë para tyre.

Me qëllim të ndërprerjes së masakrave dhe spastrimit etnik të popullsisë së Kosovës, Forcat e NATO-s, ndërmorën aksionet ushtarake ndaj forcave serbe në Kosovë, porse edhe brenda territorit të Serbisë, nga 24 Marsi deri me 12 Qershor 1999, të cilat rezultuan me mundjen dhe tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, si rezultat i Marrëveshjes së Kumanovës.

Pas hyrjes së forcave të NATO-s, sipas marrëveshjes së Këshillit të Sigurimit, të njohur si Rezoluta 1244, në Kosovë u vendosën Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara.

Në periudhën e muajve dhe viteve të para pas çlirimit të Kosovës, ishte rindërtimi i infrastrukturës dhe shtëpive të banimit në ter Kosovën, të cilat ishin shkatërruar deri në atë masë, saqë, ngadalësonin kthimin e popullsisë së dëbuar. Në ofrimin e ndihmave dhe financimit të Rindërtimit dhe ngritjes së standardit të jetesës së popullsisë së dërrmuar, më së shumti kanë kontribuar dërgesat e Diasporës/Mërgatës së Kosovës dhe donacionet e organizatave ndërkombëtare nga shumë vende mike të Kosovës.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008, në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme ku merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

4.18. Vlerat dhe gjurmët e traditës urbane të Prishtinës

Në traditën qytetare për vlerat e artit, dhe dekorimet e brendshme në shtëpitë qytetare, por edhe në fshatra të komunës së Prishtinës, ishin të njohur mjeshtrit shqiptar, që lanë vepra të çmuara të traditës tonë popullore. Në gdhendjet e drurit, ashtu sikurse në gurë dhe pëlhurë, mjeshtri popullore shqiptarë, arriti të realizoj vepra të përsosura për kohën. Kryesit në gdhendje hasim simbolet astrale, që i përdorën popujt e lashtë që nga periudhat e hershme të historisë. Zakonisht është skalitur ylli gjashtëcepësh, pastaj tetë cepësh, hëna, dielli, gjarpri dhe dekorime me motive bimore.

4.19. Pozita Gjeografike e rajonit të Komunës së Prishtinës, Kryeqyteti dhe fshatrat përreth

Prishtina shtrihet në një rrafsh aluvial në rajonet e Llapit dhe Kosovës përgjatë kodrave të Gollakut në Kosovën qendrore dhe lindore. Trupat ujorë në Komunën e Prishtinës përfshijnë liqenet e Badocit dhe Batllavës si dhe lumenjtë Llap, Prishtevka dhe Vellusha. Parku i Gërmisë shtrihet në lindje të Prishtinës dhe shtrihet në veri të fshatrave Llukar dhe Kolovicë në jug në Badoc.

Prishtina shtrihet në mes të përrojeve të vegjël, Prishtinës, Vellushës dhe Matiqanit, që rrjedhin nga kodrinat xehetarie në anën perëndimore të malësisë së Gallabit. Në anën jugore dhe perëndimore Prishtina kufizohet me toka pjellore të fushës së Kosovës. Lartësia mbidetare sillet prej 585m , 640, 670 dhe rreth 700 m lartësi në disa lagje të qytetit.

4.20. Kushtet klimatike të komunës së Prishtinës

Lartësia mbidetare e komunës së Prishtinës është 535-580 m, karakterizohet me klimë të ndryshueshme kontinentale me ndikim të vogël të klimës së mesme, me karakteristika kontinentale dhe subalpine. Temperaturat mesatare vjetore, sipas të dhënave meteorologjike shumëvjeçare (2002-2016), sillen prej 10.4 deri 11.9°C. Temperaturat më të ulëta mesatare janë gjatë periudhës dhjetor-janar dhe më të lartat në korrik. Reshjet nuk paraqiten në mënyrë uniforme gjatë vitit. Sasia e shiut ndryshon në masë të konsiderueshme nga viti në vit prej nivelit më të ulët 33.9 mm deri në atë më të lartë 74.7 mm. Zakonisht reshjet më të mëdha janë në tetor, nëntor, dhjetor dhe më të ulëta në korrik-gusht. Ky element është veçanërisht i rëndësishëm për planifikimin e prodhimit intensiv të hortikulturës, veçanërisht për perime, patate, dhe misër e bimë industriale si duhani, luledielli dhe soja.

4.21. Burimet ujore të komunës së Prishtinës

Prishtina është një nga zonat urbane me mungesën më të madhe të ujit në Kosovë. Popullsia e saj duhet të përballet me frenimin e përditshëm të ujit për shkak të mungesës së shiut dhe reshjeve të borës, gjë që e ka lënë furnizimin me ujë të Prishtinës në një gjendje të rendë. Furnizimi me ujë vjen nga dy rezervuarët kryesorë të Batllavës dhe Badocit. Megjithatë, ka shumë probleme me furnizimin me ujë që vjen nga këta dy rezervuarë të cilët furnizojnë 92% të popullsisë së Prishtinës. Si të tilla, autoritetet kanë shtuar përpjekjet e tyre për të korrigjuar situatën dhe për t'u siguruar që kriza të tilla të mos godasin përsëri qytetin.

Lumenjtë në komunën e Prishtinës kryesisht mbushen nga të reshurat dhe nga shkrirja e borës. Prandaj, sasia e ujit në lumenj varet nga sasia e ujit të rrjedhshëm dhe sipërfaqes së ujit. Për këtë arsye, niveli më i lartë i rrjedhës së lumenjve (rreth 70%) ndodhë në periudhën jo-vegjetative (tetor-prill), kurse pjesa tjetër (30%) rrjedhë gjatë periudhës vegjetative. Kjo edhe më tej përforcon faktin që shpërndarja e reshjeve gjatë vitit është e pafavorshme. Gjatë muajve të verës, kur rritet nevojave e bimëve për ujitje, shumë përroje dhe lumenj thahen plotësisht, përderisa niveli i ujit në lumenjtë e mëdhenj bie në nivel minimal. Një situatë e tillë e pafavorshme shkakton mungesë të ujit për prodhimtari intensiv bujqësorë gjatë muajve të verës dhe të fillim-vjeshtës. Kjo mungesë e ujit përbën kufizimin kryesor për zhvillimin

e prodhimitarisë bujqësore në komunën e Prishtinës, si dhe për zgjerimin e zonës së ujitjes. Bazuar në statistikat e prezantuara nga MBPZHR tregojnë se nga sipërfaqja totale e prodhimitarisë bujqësore në komunën e Prishtinës, përmes burimit të ujit Iber-Lepenc ujitet 231 ha dhe kryesisht janë kulturat si patate dhe misër. Një pjesë e tokës në rajonin e Prishtinës ujitet nga lumi Llapi përmes rënies së lirë kurse një pjesë tjetër ka potencial të ujitet nga hidro-sistemi Ibër. Sidoqoftë, në shumë fshatra të këtij rajoni nuk ka ujitje.

Për pije, higjienë dhe nevojat esenciale për ujë të banorëve të Prishtinës me rrethinë, burimet e ujit janë nga digat, në Badoc me vëllim prej 31.6 x 106 m³, Batllavë me vëllim prej 35 x 106 m³, Gazivodë në shtratin e lumit Iber etj. Megjithatë, për të adresuar nevojat për ujë në rajonin e Komunës së Prishtinës për të gjitha qëllimet (pirje, bujqësi, industri, peshkimi etj.), nevojitet sigurimi i furnizimit nga burime të tjera të akumulimit të ujit.

4.22.Pyjet në zonat malore të komunës së Prishtinës

Pyjet përfshinë 481,000 ha apo 45% nga sipërfaqja totale e tokës në Kosovë (Raporti i Gjelbër, 2017). Territori i komunës së Prishtinës është i rrethuar nga pyje masive që posedojnë hidrografi të theksuar, kryesisht me bimë fletëgjera, dhe një pjesë e tyre shfrytëzohet për djegie 1,057 m³ (Raporti i Gjelbër, 2017). Fshatrat e këtij rajoni karakterizohen me male të ulëta dhe të mesme të cilat hasen në pjesën lindore. Zonat pyjore janë resurse natyrore dhe është përgjegjësi e të gjitha palëve relevante në komunën e Prishtinës që të angazhohen në shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe efikas të këtyre resurseve. Është e rëndësishme që fillimisht të ndalet prerja e paligjshme, duke respektuar strukturat administrative të vendit për përdorimin efikas të pyjeve dhe të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e pyjeve dhe të industrisë pyjore. Për shkak të kërkesës për lëndë djegëse dhe material ndërtimor, pyjet e rajonit të Prishtinës janë shkatërruar mjaft dhe ky shkatërrim ende vazhdon, ndërkohë që sipërfaqe të mëdha të pyjeve janë degraduar dhe një pjesë janë rrezikuar nga zjarret. Ekziston një nevojë urgjente për pyllëzim të sipërfaqeve të reja. Për këtë arsye gjatë vitit 2016 në Komunën e Prishtinës janë pyllëzuar sipërfaqe në rreth 18 ha (Raporti i Gjelbër, 2017).

4.23.Popullsia e komunës së Prishtinës (regjistrimet 2024)

Bazuar në të dhënat e ASK'së nga regjistrimet e vitit 2024, Komuna më së shumti banorë në Kosovë, është e Prishtinës, me 227 mijë e 154 banorë. Rajoni i Komunës së Prishtinës, nga regjistrimi popullsisë 2024 arrin shifrën e 507,443 banorëve: Prishtina ka 227,154 banorë.

Në disa fshatra, veçanërisht në ato që i takojnë zonave malore të Gallapit/Gollakut, vërehet një lëvizje e madhe e popullatës (veçanërisht të rinjve) drejt zonave urbane. Si rezultat i kësaj lëvizje ka pasur zvogëlim të fuqisë punëtore në fshatrat malore të Gallapit. Prandaj, disa fshatra (Nisheci, Radasheci, Kukaj, Hajkobilë, Gillogovicë etj.) kanë numër dukshëm më të vogël të banorëve, gjë që është një nga problemet kryesore në zonat rurale.

Papunësia është një prej problemeve të mëdha në zonat rurale (si edhe në tërë Kosovën). Mundësitë për punësim në këto fshatra janë të kufizuara. Mungesa e kapaciteteve përpunuese dhe mungesa e investimeve për zhvillim të bujqësisë moderne kanë shkaktuar ngecje në disa rajone (veçanërisht në ato malore), duke shkaktuar një ngecje në bujqësi dhe migrim drejt rajoneve urbane ose madje edhe jashtë vendit.

5. Niveli i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë dhe rajonin e komunës së Prishtinës

Tabela 4. Numri i ekonomive bujqësore sipas Regjionit

	Numri	Përqindje (%)
Prishtinë	31966.0	24.7

5.1. Kultivimi i drithërave në rajonin e Komunës së Prishtinës

Në rajonin e Komunës së Prishtinës, kulturat kryesore që kultivohen janë drithërat (3,612.36 ha), ku kultura kryesore është gruri dhe misri, ku nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës së punueshme bujqësore 2,470 ekonomi shtëpiake mbjellin drithëra (ASK, Kulturat e arave në republikën e Kosovës 2014). Për të zhvilluar bujqësinë organike, është e nevojshme të kultivohen bimë foragjere për ushqimin e kafshëve. Sipërfaqja më e madhe e kulturave foragjere në Prishtinë mbillet me jonxhë dhe tërfil . Përmirësimi i bazës ushqyese të kafshëve është thelbësor për rimëkëmbjen e kafshëve, duke përfshirë kafshët për mish, lopët qumështore, delet, shpezët etj. Prandaj, kulturat foragjere përbëjnë një potencial të mirë në bujqësinë organike, por sipërfaqet e mbjella me këto kultura duhet të rriten.

Gruri kultivohet për të shërbyer si burim kryesor i furnizimit të ushqimit për familje, ndërsa misri, kryesisht për ushqimin e kafshëve. Në mënyrë të ngjashme, një pjesë e grurit gjithashtu kthehet në ushqim për kafshë pasi të konvertohet në krunde (KAS, 2015).

5.2. Kultivimi i perimeve në rajonin e Komunës së Prishtinës

Në vitin 2014, 135.91 ha ose 1.2% e sipërfaqes së punueshme janë të kultivuar me perime, të shpërndara në 1,347 ekonomi bujqësore. Kultivimi i perimeve dhe patates në fshatrat e Komunës së Prishtinës është mjaft i ndryshueshëm. Në fshatrat e pjesës perëndimore dhe jug-perëndimore, prodhimi i perimeve dhe patateve është më i avancuar dhe ekziston një traditë relativisht e mirë. Perimet më të kultivuara janë lakrat, domatet, specat, etj. ndërsa më pak sallata jeshile, trangujt, karotat pastinake, lulëlakrat, etj. të cilat kërkohen mjaft shumë në tregun e Prishtinës. Patatet prodhohen dhe konsumohen në sasi të mëdha. Patatja është e vetmja me një rrjedhje të konsiderueshme të eksportit që tejkalon importin sa i përket vëllimit. Megjithatë, vlera e patateve të eksportuara është shumë më e ulët krahasuar me ato që importohen. Patatet eksportohen kryesisht si patate të papërpunuara, ndërsa shumica e atyre që importohen janë patate me vlerë të shtuar. Madhësia mesatare e kultivuesve të patateve është e vogël, ndërsa kultivuesit më të mëdhenj të patates (zakonisht me më shumë se 3 ha patate) kanë më shumë gjasa të jenë të lidhur me zinxhirë të organizuar të furnizimit. Në disa zona rurale të Komunës së Prishtinës (Gallapi) ekzistojnë kushte shumë të favorshme për shumëzimin e farës së patates. Në tregjet vendore referenca kryesore për negociim të çmimeve ditore është tregu me shumicë në Prishtinë. Cilësia e prodhimit është një parakusht për kultivuesit e patateve sidomos sa i përket qasjes në tregjet e eksportit.

Perimet e subvencionuara më shumë ishin speci, shalqiri dhe patatja. Rendimenti mesatar për patate në vitin 2016 është regjistruar në 25.97 t/ha.

Prodhimi i specit dominohet nga fermat e vogla që përbëjnë rreth 2/3 e të gjitha fermave që merren me kultivimin e specit, të ndjekura nga fermat gjysmë komerciale me 30% dhe fermat komerciale me më shumë se 2 hektarë përbëjnë vetëm 6% e fermave në përgjithësi.

Sidoqoftë, kohët e fundit, interesimi i fermerëve për këtë prodhim është në rritje për shkak të arsyeve ekonomike, nevojave të tregut lokal për perime të freskëta, mbylljes së tregut etj., prandaj mbështetja

dhe asistenca për zhvillimin e vazhdueshëm të prodhimeve për perime duhet të jetë një nga aktivitetet kryesore të sektori të bujqësisë në Komunën e Prishtinës.

5.3. Kultivimi pemëve në rajonin e Komunës së Prishtinës

Në vitin 2014, Kosova kishte një sipërfaqe të përgjithshme prej 5,668 ha me pemë , prej të cilave 240.17 ha kultivohen në komunën e Prishtinës të shpërndara në 548 ekonomi bujqësore. Pjesa më e madhe e plantacioneve të pemëve ishin të mbjella me mollë. Shkalla e vet-mjaftueshmërisë në vitin 2016 në nivel vendi mbulon rreth 70% të nevojave. Çmimi mesatar i mollës për periudhën kohore 2008-2016 ishte 0.49 EUR, përderisa bilanci tregtar i mollës në nivel vendi vazhdon të jetë negativ. Për kulturën e kumbullës shkalla e vet-mjaftueshmërisë në nivel vendi në vitin 2016 ishte 97%, ndërsa vlera e prodhimit ishte 5.6 milion Euro.

Sektori i frutave të imta në komunën e Prishtinës ka kaluar një rrugëtim më të mirë se sa sektori i perimeve sa i përket investimeve në plantacione të reja dhe aktivitete të përpunimit. Investimet në përpunimin e frutave inkurajohen nga zhvillimi dhe prodhimi në rritje veçanërisht i mjedrave dhe dredhëzave. Kushtet agroekologjike në komunën e Prishtinës për zhvillimin e këtij sektori në zonat rurale janë mjaftë të favorshme dhe kërkesat e tregut për këto produkte janë të mëdha.

5.4. Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbra

Një pjesë e madhe e sipërfaqes bujqësore i është ndarë kulturave foragjere si misri i gjelbër, sana, bari, jonxha, tërfili dhe kultura të tjera foragjere të gjelbra. Kulturat ushqyese përfaqësojnë grupin e dytë më të rëndësishëm të kulturave në tokë të punueshme. Kjo fushë nuk përfshin livadhet e sanëve, siç ishte rasti në vitet e mëparshme. Ekzistojnë gjithsej 33,915 ekonomi bujqësore, të cilat kanë mbjellë kultura foragjere dhe drithëra të gjelbra. Sipërfaqja e mbjellë në komunën e Prishtinës përbën 21%.

Tabela 5. Shpërndarja e sipërfaqes së kulturave foragjere dhe ekonomive bujqësore sipas regjioneve

	Kosovë	Prishtinë
Ekonomitë bujqësore	33,915	7,890
Kulturat foragjere	26,554	5,696
Përqindja (%)	100	21

Burimi: KAS- Regjistrimi i bujqësisë 2014

5.5. Bimët mjekësore dhe frutat e malit në rajonin e komunës së Prishtinës

Komuna e Prishtinës definohet si pyjore kryesisht me bimë fletëgjera dhe përfshin një sipërfaqe 28,284 ha. Sipërfaqet pyjore paraqesin burime natyrore prandaj konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre është obligim i të gjitha institucioneve.

Zonat pyjore janë shumë të rëndësishme pasi që përmbajnë një numër të konsiderueshëm të bimëve mjekësore, kërpudhave dhe frutave të malit, që lehtësisht mund të certifikohen si produkte organike. Për momentin, shumica e popullatës që jeton në zonat rurale të komunës së Prishtinës, grumbullojnë PPJD dhe disa prej tyre kanë filluar kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Grumbulluesit dhe kultivuesit e këtyre llojeve të bimëve kryesisht jetojnë në zona rurale me potencial për këto lloje bimore duke përfshirë të gjithë anëtarët e familjes. Grumbulluesit varësisht nga kërkesa dhe çmimi, grumbullojnë lloje të ndryshme të bimëve gjatë ditës dhe në mbrëmje i shesin produktet e tyre. Megjithatë, shumica e tyre produktet i shesin direkt kompanive të mëdha që grumbullojnë PPJD, mirëpo në disa zona kanë filluar të krijohen qendra grumbulluese për grumbullimin e PPJD-ve. Shumica e produkteve të grumbulluara kryesisht shiten si të freskëta, pasi grumbulluesit nuk posedojnë tharës për bimë apo trajtimin pas mbledhjes, siç është pastrimi, klasifikimi, pasi që u

mungojnë mjetet për të kryer këto aktivitete. Është mjaft karakteristike të përmendet se ky sektor është mjaft interesant edhe për gjininë femërore, kështu që një numër i konsiderueshëm i grave janë përfshirë në këtë sektor. Prandaj në të ardhmen duhet kushtuar vëmendje të veçante përfshirjes së gjinisë femërore në këtë sektor, pasi që është fitimprurës dhe me rëndësi për zhvillim ekonomik në Komunën e Prishtinës.

5.6. Zhvillimi i fondit të Bagëtive në rajonin e komunës së Prishtinës

Bagëtitë përbëjnë një prej nën-sektorëve më të rëndësishme të bujqësisë në Kosovë. Gjatë viteve të periudhës së pasluftës, numri i bagëtive arriti një nivel të ngjashëm me nivelin e para luftës. Në vitin 2014, në Kosovë kishte 52,475 gjedhe të shpërndara në 15,147 ekonomi familjare. Në 2014, numri i gjedheve në Kosovë ishte 261,689. Në Komunën e Prishtinës fondi total i gjedheve 7,266 të shpërndara në 1359 ekonomi bujqësore (Tabela 10).

Tabela 6. Numri i kafshëve sipas llojeve sipas vitit dhe Fondi blegtoral

	Gjedhe	Dele	Dhi	Derra	Njëthundrakë	Shpezë	Koshere bletësh
Viti 2022	250899	204110	29378	45420	1469	2614438	196122
Përditësimi i fundit: 20230927 00:00							

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK

Tabela 7. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i lopëve në Prishtinë, 2014

	Kosovë	Prishtina
Ekonomitë bujqësore	66,589	1,359
Gjedhe	261,689	7,266

Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë, 2014

Në vitin 2014, në Prishtinë kishte gjithsej 111 ekonomi bujqësore që rrisnin dele dhe dhi. Numri i deleve është zvogëluar për 5%, derisa në anën tjetër numri i dhive është rritur. Një prej faktorëve që mund të ketë ndikuar në këtë gjë është përfitimi më i madh nga dhitë në krahasim me delet. Kritja e vazhdueshme e subvencioneve të drejtpërdrejta për kokë të deleve dhe dhive mund të jetë një faktor i rëndësishëm që nxitë fermerët të rrisin numrin e tyre.

Tabela 8. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i deleve në Prishtinë, 2014

	Kosova	Prishtina
Ekonomi bujqësore	2,466	59
Dele	183,584	5,733

Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë, 2014

Tabela 9. Numri i ekonomive bujqësore dhe numri i dhive në Prishtinë, 2014

	Kosova	Prishtina
Ekonomi bujqësore	2,221	52
Dhi	28,430	1,275

Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë, 2014

Aktivitetet bujqësore (fermat) që merren me dele dhe dhi në mënyrë dominuese janë të vendosura dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në zona të thella rurale. Këto ferma prodhojnë dy produkte kryesore, mish dhe djathë, përderisa qumështi përbën vetëm një pjesë të vogël të burimit të të hyrave, pasi që pjesa më e madhe e qumështit shkon për prodhim të djathit dhe për konsumim familjar.

Blegtoria zënë një vend të rëndësishëm në Komunën e Prishtinës, kështu që prioritetet e blegtorisë qëndrojnë në sigurimin e produkteve blegtorale të domosdoshme për ushqimin e popullatës së këtij regjioni, pasi numri i kafshëve është reduktuar viteve të fundit. Prandaj fermerët e këtyre zonave rurale, aktivitetin në blegtori duhet orientuar në rritjen e numrit të kafshëve dhe sigurimin e riprodhimit normal, duke ndërtuar objekte bashkëkohore për vendosjen e kafshëve, prodhimin e ushqimit të kafshëve e posaçërisht sigurimin e sasive të nevojshme të ushqimeve për ushqimin dimëror të bagëtisë dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen përkatëse shëndetësore.

Duke pasur parasysh se Komuna e Prishtinës posedon rreth 7,434.22 ha kullota, në veçanti këto livadhe dhe kulloza shtrihen në zona rurale, mundësitë për bujqësi organike janë të mira dhe fermerët duhet të orientohen drejt sigurimit të ushqimit të mjaftueshëm të kafshëve për dimër dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për mbrojtjen e shëndetit të tyre.

Për të përfunduar ciklin në bujqësinë organike, është e nevojshme të kultivohen kultura foragjere për ushqimin e kafshëve. Sipërfaqja më e madhe e kulturave foragjere mbillet me jonxhë, tërfili, bizele, etj.

Në malësinë e Gallapit (Gollakut) dominojnë livadhet dhe kullozat, 80% e këtyre zonave janë livadhet dhe kullozat natyrore, dhe gati 20% të këtyre zonave janë livadhe dhe kulloza. Livadhet dhe kullozat përdoren shumë pak, përmes kositjes dhe kullotjes së lirë të bagëtive. Funkcionimi më i mirë dhe trajnimi i fermave ekzistuese, duhet të orientohen drejt prodhimit të qumështit organik dhe produkteve të qumështit si produkte bazë si dhe mishit organik. Megjithatë, zonat rurale kanë kushte të mira për t'u marrë me kultivim të suksesshëm të bagëtive të tjera (dele, dhi dhe shpezë). Pra, edhe nga këto kafshë dhe shpezë, me një punë adekuate, në të ardhmen fermerët mund të arrijnë rezultate financiare pozitive.

5.7. Bujqësia adaptive ose e përshtatur

Bujqësia adaptive i referohet praktikave bujqësore që janë krijuar për të përshtatur dhe për t'iu përgjigjur kushteve mjedisore në ndryshim, të tilla si ndryshimet klimatike, degradimi i tokës dhe mungesa e ujit. Kjo qasje thekson fleksibilitetin, elasticitetin dhe qëndrueshmërinë në sistemet bujqësore. Duke u fokusuar në këto strategji, bujqësia adaptive synon të krijojë sisteme bujqësore që janë të qëndrueshme, elastike dhe të afta për t'i bërë ballë pasigurive të një mjedisi në ndryshim.

Tabela 10. Disa aspekte kryesore të bujqësisë adaptive ose të përshtatura ndryshimeve mjedisore

Nr.	Sistemet bujqësore	Praktikat adaptive bujqësore sipas kushteve mjedisore në ndryshim
1.	Qëndrueshmëria ndaj klimës	<ul style="list-style-type: none"> Bujqësia adaptive përfshin përzgjedhjen e të korrave dhe teknikave bujqësore që janë elastike ndaj ngjarjeve ekstreme të motit, si thatësitrat, përmytjet ose valët e të nxehtit. Kjo mund të përfshijë mbjelljen e varieteteve të kulturave rezistente ndaj thatësisë ose diversifikimin e kulturave për të zvogëluar rrezikun e dështimit total të të korrave.
2.	Menaxhimi i ujit	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi efikas i ujit është thelbësor në bujqësinë adaptive. Teknikat si ujitja me pika, vjelja e ujit të shiut dhe përdorimi i kulturave mbuluese ndihmojnë në ruajtjen e ujit dhe ruajtjen e lagështirës së tokës.
3.	Shëndeti i tokës	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e tokës së shëndetshme është një gur themeli i bujqësisë adaptive. Praktikat si rrotullimi i të korrave, mbjellja me mbulesë, punimi i reduktuar dhe përdorimi i plehrave organike ndihmojnë në përmirësimin e strukturës së tokës, pjellorisë dhe aktivitetit mikrobik, duke e bërë tokën më elastike ndaj kushteve të ndryshimit.
4.	Agropylltaria	<ul style="list-style-type: none"> Integrimi i pemëve dhe shkurreve në sistemet bujqësore mund të ofrojë përfitime të shumta, duke përfshirë pjellorinë e përmirësuar

		të tokës, rritjen e biodiversitetit, sekuestrimin e karbonit dhe mbrojtjen nga era dhe erozioni i tokës.
5	Menaxhimi i integruar i dëmtuesve (IPM)	<ul style="list-style-type: none"> Në vend që të mbështetet shumë në pesticidet kimike, bujqësia adaptive promovon përdorimin e agjentëve të kontrollit biologjik, rotacionin e të korrave dhe menaxhimin e habitatit për të kontrolluar dëmtuesit, duke reduktuar rrezikun e shpërthimeve të dëmtuesve.
6.	Diversifikimi	<ul style="list-style-type: none"> Diversifikimi i të korrave, blegtorisë dhe praktikave bujqësore ndihmon në përhapjen e rrezikut dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë. Për shembull, sistemet e përziera bujqësore që kombinojnë të korrat dhe blegtorinë mund të përdorin më mirë burimet dhe të zvogëlojnë ndikimin e luhatjeve të tregut ose mjedisit.
7.	Teknologjia dhe inovacioni	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i teknologjisë moderne, si bujqësia precize, sensori në distancë dhe analiza e të dhënave, u mundëson fermerëve të monitorojnë kushtet në kohë reale dhe të marrin vendime të informuara që përmirësojnë efikasitetin dhe produktivitetin.
8.	Komuniteti dhe shkëmbimi i njohurive	<ul style="list-style-type: none"> Bujqësia adaptive shpesh përfshin bashkëpunimin midis fermerëve, studiuesve dhe politikë bërësve për të shkëmbyer njohuri, përvoja dhe inovacione që mund të ndihmojnë të gjithë komunitetin të përshtatet me ndryshimet.
9.	Mbështetja e politikave	<ul style="list-style-type: none"> Politikat e qeverisë që mbështesin bujqësinë adaptive përmes subvencioneve, kërkimit dhe shërbimeve të ekstensionit janë thelbësore. Këto politika mund të ndihmojnë fermerët të kenë qasje në resurset dhe njohuritë që u nevojiten për të zbatuar praktikat adaptive.

5.8. Agroekologjia, koncept dhe praktikë e re e avancimit integruar në sistemet bujqësore

Agroekologjia është një qasje integruese që zbaton parimet ekologjike në sistemet bujqësore, që fokusohet në ndërveprimet midis bimëve, kafshëve, njerëzve dhe mjedisit brenda sistemeve bujqësore. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) dhe studiues të ndryshëm agroekologjikë, kanë përshkruar disa parime kryesore që udhëheqin praktikën agroekologjike. Këto parime drejtojnë zhvillimin e sistemeve ushqimore të qëndrueshme, elastike dhe shoqërore, të drejta që janë në përputhje me kontekstet ekologjike dhe kulturore.

Më poshtë janë: *13 parime të njohura gjerësisht të agroekologjisë:*

- Diversiteti:** Promovimi i biodiversitetit brenda sistemeve bujqësore. Kjo përfshin diversitetin gjenetik, të specieve dhe të ekosistemit, i cili rrit elasticitetin dhe produktivitetin.
- Bashkë-krijimi i njohurive:** Kombinimi i njohurive tradicionale, burimore dhe shkencore për të inovuar dhe përshtatur praktikën agroekologjike me kontekstet lokale.
- Sinergjia:** Krijimi i sinergjisë mes elementeve të ndryshëm të agroekosistemit, të tilla si të korrat, kafshët dhe organizmat e tokës, për të optimizuar performancën e përgjithshme të sistemit.
- Efikasiteti:** Optimizimi i përdorimit të resurseve (p.sh., uji, energjia, lëndët ushqyese) dhe zvogëlimi i mbështetjes në inputet e jashtme, duke minimizuar mbetjet dhe ndikimin mjedisor.
- Riciklimi:** Mbyllja e cikleve të lëndëve ushqyese dhe të energjisë, duke ricikluar lëndën organike dhe lëndët ushqyese brenda fermës, për të reduktuar varësinë nga inputet e jashtme dhe për të përmirësuar pjellorinë e tokës.
- Rezistenca:** Ndërtimi i kapacitetit të sistemeve bujqësore, për t'i bërë ballë dhe për t'u

rikuperuar nga shqetësimet (p.sh. ndryshimet klimatike, dëmtuesit, sëmundjet), përmes diversitetit dhe menaxhimit përshtatës.

7. **Vlerat Njerëzore dhe Sociale:** Vënia në përparësi të vlerave njerëzore dhe sociale, duke siguruar barazi, drejtësi dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse dhe fuqizimin e komuniteteve, veçanërisht grupeve të marginalizuara.
8. **Kultura dhe traditat e ushqimit:** Respektimi dhe përmirësimi i kulturave lokale dhe traditave ushqimore, të cilat janë integrale për identitetin dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve.
9. **Qeverisja e Përgjegjshme:** Promovimi i sistemeve gjithëpërfshirëse dhe transparente të qeverisjes që sigurojnë qasje në resurse, drejtësi dhe pjesëmarrje për të gjitha palët e interesuara.
10. **Ekonomia rrethore dhe solidare:** Mbështetja e ekonomive lokale që janë rrethore, duke reduktuar mbetjet dhe duke promovuar ndarjen, bashkëpunimin dhe tregtinë e drejtë.
11. **Lidhja me natyrën:** Nxitja e lidhjeve të thella me natyrën, duke njohur ndërvarësinë e mirëqenies njerëzore dhe ekosistemeve të shëndetshme.
12. **Parimi i parandalimit:** Aplikimi i masave paraprake në vendimmarrje, veçanërisht përballë pasigurisë, për të shmangur dëmtimin e njerëzve dhe mjedisit.
13. **Qeverisja novatore:** Inkurajimi i kornizave të qeverisjes, që janë përshtatëse, pjesëmarrëse dhe të përafuara me parimet agroekologjike për të mbështetur tranzicionet e qëndrueshme.

5.9. Zhvillimi i integruar rural në Zonat Rurale të komunës së Prishtinës

Zhvillimi i integruar rural është një qasje që synon të përmirësojë cilësinë e jetës dhe mirëqenien ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat rurale. Ai përfshin një përpjekje të koordinuar për të trajtuar aspekte të ndryshme të jetës rurale, duke përfshirë bujqësinë, infrastrukturën, arsimin, shëndetin dhe shërbimet sociale. Qëllimi është krijimi i një përmirësimi të qëndrueshëm në komunitetet rurale.

1. **Zhvillimi i Bujqësisë:** Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë bujqësore nëpërmjet teknikave më të mira bujqësore, qasjes në tregun e farës dhe plehrave cilësore, si dhe mbështetje për blegtorinë dhe peshkimin.
2. **Zhvillimi i Infrastrukturës:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës si rrugët, urat, sistemet e furnizimit me ujë dhe objektet sanitare për të përmirësuar lidhjen dhe kushtet e jetesës.
3. **Arsimi dhe trajnimet profesionale:** Sigurimi i qasjes në arsim cilësor dhe trajnim profesional për të përmirësuar normat e shkrim-leximit dhe nivelet e aftësive në mesin e popullatës rurale.
4. **Kujdesi shëndetësor:** Sigurimi i qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kujdesin primar shëndetësor si ambulantët, si dhe spitalet, klinikat dhe programet parandaluese shëndetësore, për të përmirësuar shëndetin e përgjithshëm dhe për të reduktuar përhapjen e sëmundjeve.
5. **Diversifikimi ekonomik:** Promovimi i aktiviteteve ekonomike jo-bujqësore si industrinë e vogla, zëjtaria dhe turizmi për të reduktuar varësinë vetëm nga bujqësia, dhe për të krijuar burime shtesë të të ardhurave në bashkëveprim të koordinuar në mes të bujqësisë dhe shërbimeve siç është Agroturizmi.
6. **Pjesëmarrja e komunitetit:** Përfshirja e komuniteteve lokale në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve zhvillimore për të siguruar që ato të përmbushin nevojat dhe prioritetet aktuale të njerëzve.
7. **Qëndrueshmëria Mjedisore:** Promovimi i praktikave të qëndrueshme mjedisore për të ruajtur resurset natyrore dhe për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të mjeteve të jetesës rurale.

8. **Përfshirja sociale:** Trajtimi i çështjeve të pabarazisë sociale dhe sigurimi që grupet e marginalizuara, duke përfshirë gratë, fëmijët dhe pakicat etnike, të kenë qasje të barabartë në burime dhe mundësi.
9. **Qeverisja dhe Mbështetja Institucionale:** Forcimi i institucioneve të qeverisjes vendore, përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies dhe sigurimi i zbatimit efektiv të politikave dhe programeve.
10. **Qasja në financa:** Ofrimi i shërbimeve financiare si kreditë, kursimet dhe sigurimet për popullsinë rurale për të mbështetur aktivitetet bujqësore dhe agroturizmit, si dhe bizneset e vogla.

5.10. Përkrahja e zhvillimit të integruar në zonat rurale të komunës së Prishtinës

Përkrahja e zonave rurale është thelbësore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimin e jetesës dhe reduktimin e pabarazive midis zonave urbane dhe rurale. Këtu është një qasje gjithëpërfshirëse për mbështetjen e zonave rurale, duke u fokusuar në aspekte të ndryshme që mund të nxisin rritjen dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës për popullsinë rurale. Duke u fokusuar në këto fusha dhe forma, përkrahja për zonat rurale mund të çojë në përmirësimin e standardeve të jetesës, rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Kjo qasje holistike siguron që zonat rurale të mos mbeten prapa në axhendën e zhvillimit më të gjerë kombëtar dhe global.

5.11. Zhvillimi i bujqësisë në zonat rurale të Komunës së Prishtinës

Zhvillimi bujqësor i referohet procesit të përmirësimit të efikasitetit, produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së bujqësisë dhe aktiviteteve të lidhura me to. Zhvillimi i bujqësisë është thelbësor për sigurinë ushqimore, rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë, veçanërisht në vendet në zhvillim, ku një pjesë e madhe e popullsisë varet nga bujqësia për jetesën e tyre.

Në kuadër të këtyre proceseve mund të përfshihen:

1. **Përparimet teknologjike:** Prezantimi i mjeteve, makinerive dhe teknikave moderne, për të përmirësuar rendimentet e të korrave, për të zvogëluar fuqinë punëtore dhe për të rritur efikasitetin.
2. **Varietetet e përmirësuara të kulturave:** Zhvillimi dhe mbjellja e varieteteve të bimëve me rendiment të lartë, rezistente ndaj sëmundjeve dhe tolerante ndaj thatësisë për të rritur produktivitetin.
3. **Ujitja dhe Menaxhimi i Ujërave:** Zbatimi i sistemeve efikase të ujitjes dhe praktikave të menaxhimit të ujit, për të siguruar që të korrat të marrin ujë të mjaftueshëm, veçanërisht në rajonet e thata.
4. **Shëndeti dhe pjelloria e tokës:** Rritja e cilësisë së tokës, përmes përdorimit të plehrave organike dhe inorganike, rotacionit të të korrave dhe praktikave të tjera për ruajtjen e pjellorisë së tokës.
5. **Praktikat e qëndrueshme:** Promovimi i praktikave që minimizojnë ndikimin mjedisor, si p.sh. kultivimi i tokës, menaxhimi i integruar i dëmtuesve dhe Agro-pylltaria (mbjellja dhe kultivimi ose përkujdesja për drunjtë).
6. **Qasja në tregje:** Zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave që përmirësojnë qasjen e fermerëve në tregjet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u mundësuar atyre, të shesin produktet e tyre në mënyrë më efektive.
7. **Shërbimet financiare:** Ofrimi fermerëve të kredive, sigurimeve dhe shërbimeve tjera financiare të favorshme, për t'i ndihmuar ata të investojnë në fermat e tyre dhe të menaxhojnë rreziqet.
8. **Edukimi dhe trajnimi:** Ofrimi i edukimit dhe trajnimit për fermerët, mbi praktikat moderne bujqësore, menaxhimin e biznesit dhe teknikat e qëndrueshme të bujqësisë.

9. **Politika dhe Mbështetja Institucionale:** Krijimi dhe integrimi i politikave dhe institucioneve mbështetëse qendrore dhe komunale, që inkurajojnë rritjen bujqësore, si subvencionet dhe grantet, hulumtimi dhe zhvillimi, si dhe programet e zhvillimit rural.

6. Zhvillimi i Infrastrukturës si komponent kyç i Zhvillimit të Integruar Rural

Një nga komponentët kyç të IRD është Zhvillimi i Infrastrukturës, i cili luan një rol kritik në rritjen e cilësisë së jetës dhe mundësive ekonomike për popullsinë rurale. Zhvillimi efektiv i infrastrukturës brenda kontekstit të Zhvillimit të Integruar Rural është thelbësor për transformimin e zonave rurale në komunitete të gjalla dhe të vetë-qëndrueshme.

Nr.	Zhvillimi efektiv i infrastrukturës brenda kontekstit të Zhvillimit të Integruar Rural në zonat rurale të komunës së Prishtinës	
	Llojet e infrastrukturës	Format zhvillimore të infrastrukturës
L1.	Infrastruktura e Transportit	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Rrugët dhe urat: Zhvillimi i rrugëve dhe urave të çdo moti, është thelbësor për lidhjen e zonave rurale me tregjet, shkollat dhe objektet e kujdesit shëndetësor. Transporti i përmirësuar redukton izolimin, lehtëson tregtinë dhe rrit aksesin në shërbime. ✚ Transporti publik: Krijimi i sistemeve të besueshme të transportit publik, si autobusët ose automjetet e komunitetit, mund të ndihmojë popullsinë rurale të qaset në shërbimet e largëta dhe mundësitë e punësimit.
L2.	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Qasja në ujë të pastër: Ndërtimi i infrastrukturës për furnizim të besueshëm dhe të pastër me ujë është thelbësor për përmirësimin e shëndetit publik dhe mbështetjen e bujqësisë. ✚ Objektet sanitare: Zhvillimi i sistemeve të duhura sanitare, duke përfshirë tualetet dhe menaxhimin e mbeturinave, është kritik për reduktimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e higjienës së përgjithshme në komunitetet rurale.
L3.	Infrastruktura energjetike	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Elektrifikimi: Zgjerimi i qasjes në energji elektrike përmes zgjerimit të rrjetit ose burimeve të rinovueshme të energjisë (Solare, nga era, mini-rrjete) fuqizon komunitetet rurale, duke mundësuar arsimim, kujdes shëndetësor dhe mundësi më të mira biznesi. ✚ Pajisjet e gatimit: Promovimi i teknologjive më të pastra të gatimit, të tilla si stufat dhe furrat me LPG ose biogazi, redukton rreziqet shëndetësore që lidhen me karburantet tradicionale të biomasës.
L4.	Infrastruktura e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Telekomunikacioni: Zhvillimi i infrastrukturës celulare dhe të internetit është jetik për lidhjen e popullsisë rurale me botën më të gjerë, duke ofruar qasje në informacion, arsim dhe shërbime të qeverisjes elektronike. ✚ Shërbimet e transmetimit: Krijimi i radios komunitare dhe shërbimeve të tjera të transmetimit ndihmon në përhapjen e informacionit të rëndësishëm rreth bujqësisë, shëndetësisë dhe çështjeve të tjera relevante.
L5.	Infrastruktura Arsimore	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Shkollat: Ndërtimi dhe përmirësimi i shkollave në zonat rurale siguron qasje më të mirë në arsim, duke reduktuar shkallën e braktisjes së shkollës dhe duke përmirësuar nivelet e shkrim-leximit. ✚ Qendrat e trajnimit: Krijimi i qendrave të formimit profesional pajis popullsinë rurale me aftësitë e nevojshme për punësim në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë bujqësinë, zejtarinë dhe industrinë e vogla.
L6.	Infrastruktura e kujdesit shëndetësor	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Klinikat dhe spitalet: Zhvillimi i objekteve të kujdesit shëndetësor siguron që popullsia rurale të ketë qasje në shërbimet thelbësore

		<p>mjekësore, duke reduktuar shkallën e vdekshmërisë dhe duke përmirësuar mirëqenien e përgjithshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> Njësitë e lëvizshme shëndetësore: Për zonat e largëta, njësitë e lëvizshme shëndetësore mund të ofrojnë shërbime thelbësore të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë vaksinimet, kujdesin e nënës dhe edukimin shëndetësor.
L7.	Banimi dhe strehimi	<ul style="list-style-type: none"> Strehimi i përballueshëm: Zhvillimi i zgjidhjeve të përballueshme dhe të qëndrueshme të banimit dhe strehimit përmirëson kushtet e jetesës dhe redukton cenueshmërinë ndaj rreziqeve mjedisore si përmbytjet ose stuhitë. Qendrat Komunitare: Ndërtimi i qendrave komunitare ofron një hapësirë për tubime sociale, edukim dhe aktivitete kulturore, duke nxitur kohezionin e komunitetit.
L8.	Infrastruktura bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> Sistemet e Ujitjes: Zhvillimi i infrastrukturës së ujitjes mbështet bujqësinë, rritjen e produktivitetit dhe sigurinë ushqimore. Objektet e magazinimit: Ndërtimi i objekteve të magazinimit ndihmon në reduktimin e humbjeve pas vjeljes, duke i lejuar fermerët të ruajnë prodhimet e tyre dhe t'i shesin kur çmimet janë të favorshme.
L9.	Tregu dhe Infrastruktura Ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> Tregjet lokale: Krijimi ose përmirësimi i tregjeve lokale lehtëson tregtinë, duke ndihmuar prodhuesit rural të shesin mallrat e tyre në mënyrë më efektive. Kooperativat dhe Ndërmarrjet: Mbështetja e zhvillimit të kooperativave dhe ndërmarrjeve të vogla mundëson negociata kolektive, qasje më të mirë në burime dhe përmirësim të të ardhurave për popullsinë rurale.
L10	Infrastruktura mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> Menaxhimi i mbetjeve: Zhvillimi i sistemeve për menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin ndihmon në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm. Kontrolli i erozionit: Ndërtimi i infrastrukturës për ruajtjen e tokës dhe kontrollin e erozionit është thelbësor për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe parandalimin e degradimit të tokës.
L11	Rezistenca dhe Gatishmëria ndaj Fatkeqësive	<ul style="list-style-type: none"> Kontrolli i përmbytjeve: Ndërtimi i digave, pendëve dhe sistemeve të kullimit ndihmon në mbrojtjen e zonave rurale nga përmbytjet. Strehimoret e Emergjencave: Krijimi i strehimoreve emergjente dhe infrastrukturës së reagimit ndaj fatkeqësive përmirëson elasticitetin ndaj fatkeqësive natyrore.
	<i>Rëndësia e infrastrukturës në IRD:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Rritja ekonomike: Infrastruktura e përmirësuar tërheq investime, krijon vende pune dhe stimulon ekonominë lokale. Përfshirja sociale: Duke lidhur popullsinë rurale me shërbimet thelbësore, zhvillimi i infrastrukturës redukton pabarazinë dhe përjashtimin social. Qëndrueshmëria: Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës siguron që zonat rurale të rriten pa kompromentuar shëndetin mjedisor ose duke varfëruar burimet.
	<i>Sfidat e Zhvillimit efektiv të infrastrukturës brenda kontekstit të Zhvillimit të Integruar Rural në zonat rurale</i>	<ul style="list-style-type: none"> Financimi: Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për projektet e infrastrukturës në shkallë të gjerë mund të jetë sfidues, veçanërisht në rajonet me të ardhura të ulëta. Mirëmbajtja: Sigurimi se infrastruktura mirëmbahet me kalimin e kohës është kritike për qëndrueshmërinë e saj afatgjatë. Përfshirja e komunitetit: Përfshirja e komuniteteve lokale në planifikimin dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës siguron që zgjidhjet plotësojnë nevojat e tyre specifike dhe kanë më shumë gjasa të jenë të qëndrueshme.

6.1. Zhvillimi i Agroturizmit në Zonat Rurale të Komunës së Prishtinës

Zhvillimi i agroturizmit është një strategji efektive për diversifikimin ekonomik në zonat rurale të një vendi ose rajoni, andaj edhe të komunës së Prishtinës. Agroturizmi kombinon aktivitetet bujqësore me turizmin, duke u ofruar vizitorëve një përvojë edukative dhe rekreative në ferma dhe mjedise rurale. Kjo jo vetëm që gjeneron të ardhura shtesë për fermerët, por gjithashtu promovon kulturën dhe traditat rurale.

Konceptet dhe esenca e Agroturizmit

Agroturizmi është një formë e turizmit rural që ofron një përvojë autentike dhe të qetë duke integruar aktivitetet bujqësore në atraksionet turistike, duke shfaqur kulturën rurale si joshjen kryesore, por edhe peizazhet natyrore. Agroturizmi është një formë e rëndësishme e turizmit të komunitetit rural, që përritet në përputhje me zhvillimin ideal të turizmit rural, duke ofruar një prekje autentike në një atmosferë të qetë. Mbase, agroturizmi është një stil udhëtimiti, që promovon kulturën rurale si një atraksion turistik. Është i krahasueshëm me ekoturizmin, por atraksioni kryesor tek agroturizmi është peizazhi ose përmbajtja kulturore rurale dhe jo ai natyror.

Fushëveprimi i agroturizmit

Në shumë vende botërore, Evropiane, por edhe në shtetet fqinje të Kosovës, agroturizmi është bërë një komponent i rëndësishëm i turizmit të komunitetit lokal rural, duke ofruar përfitime të rëndësishme ekonomike dhe duke shërbyer si një pikë hyrjeje e përbalueshme për të zgjeruar gamën e industrisë së turizmit dhe udhëtimeve.

Në krahasim me llojet tjera të turizmit, shpenzimet e akomodimit, ngrënies, jetesës dhe udhëtimit janë dukshëm më të ulëta, duke ndikuar që kostot dhe shpenzimet të janë ndër faktorët parësor që mundëson zgjerimin dhe shtrirjen e agroturizmit. Për më tepër, agroturizmi ofron mundësi dhe vend për banorët rural lokal të ekspozojnë mallrat e tyre, ato artizanale të punëdores, të rritura organikisht dhe të tjera, për vizitorët vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë ata nga diaspora. Agroturizmi shërben si një mjet efektiv arsimor, duke rritur ndërgjegjësimin për jetën rurale dhe shkencën bujqësore tek fëmijët e maseve urbane të qytetit, duke ofruar një përvojë unike dhe të këndshme mësimore, duke qenë gjithashtu një formë me kosto efektive, turizmi që promovon, mundëson dhe zgjeron shitjen dhe shtrirjen e produkteve të ekonomive rurale.

Agroturizmi i qëndrueshëm

Agroturizmi nxit zhvillimin e qëndrueshëm rural, duke përfituar komunitetet rurale, duke rritur të ardhurat për punëtorët e bujqësisë dhe duke promovuar qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Një vend mund të rritet përmes agroturizmit në një mënyrë të qëndrueshme, duke u siguruar fermerëve të ardhura shtesë me një kosto të lirë investimi, që ndihmon gjendjen e tyre financiare. Për më tepër, agroturizmi i ofron fermerit një mundësi për të fituar njohje për linjën e tij të punës. Agroturizmi promovon turizmin e qëndrueshëm, duke tërhequr vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë diasporën, për të vlerësuar natyrën dhe gjelbërimin, duke ofruar aktivitete miqësore me mjedisin, duke siguruar të ardhura shtesë dhe njohje për fermerët, dhe duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme të zonave rurale.

Sfidat lidhur me nivelin e pamjaftueshëm të zhvillimit të agroturizmit

Agroturizmi përballet me sfida për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme institucionale, në planifikimin, zhvillimin dhe financimin adekuat, për shkak të mungesës së qendrave burimore funksionale dhe mangësive në planet zhvillimore dhe atij të marketingut. Vështirësitë në menaxhimin e aktiviteteve promovuese, tërheqjen e klientëve, mbledhjen e fondeve dhe adresimin e çështjeve që lidhen me fuqinë punëtore, pengojnë në masë të madhe zhvillimin e agroturizmit dhe kuptimin e nevojave të klientëve.

Implikimet për ngritjen dhe rritjen e agroturizmit

Për të nxitur rritjen e agroturizmit, mbështetja e institucioneve komunale dhe qendrore, Partneritetet Publiko-Private, ndihma financiare, angazhimi i konsulencës profesionale dhe udhëzimet e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, lidhur me planifikimin dhe nismat e projekteve, janë thelbësore për përcaktimin e një qasjeje vizionare dhe arritjen e objektivave të agroturizmit. Institucionet lokale dhe vendore duhet të mbështesin dhe të njohin turizmin dhe agroturizmin.

Qeveria e Kosovës duhet të mbështesë zhvillimin e modelit të partneritetit strategjik publiko-privat. Qeveria komunale me ndihmën e donatorëve, duhet të ofrojë ndihmë të menjëhershme financiare dhe shërbime të këshillimit të projektit “Studimi i Fizibilitetit të Zhvillimit të Turizmit të Komunitetit Lokal”, me fokus në Agroturizmin, në nivel të Komunës së Prishtinës. Pronarët e fermave, krahas përkrahjes dhe fuqizimit të bizneseve të tyre bujqësore, duhet të joshën dhe të këshillohen, në krijimin e qasjes adekuate në fillet futuriste të agroturizmit, duke përcaktuar vizionin dhe objektivin e kompanisë. Ata duhet të përkrahën me udhëzime dhe këshillime nga ekspertët vendor, si të bujqësisë ashtu edhe nga ekspertët e turizmit, me përvojë nga agroturizmi. Qeveria fokusohet në produktet me tematikë të turizmit në treg.

Nëpërmjet grantëve dhe financave institucionale, qeveria duhet të bëjë çdo përpjekje për t'i ofruar operacioneve agroturistike në Rajonin e Komunës së Prishtinës, mbështetjen më të madhe të mundshme financiare.

Krijimi dhe funksionimi i Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit të Agroturizmit për Rajonin e Komunës së Prishtinës, si hub i ofruesve të shërbimeve të agroturizmit, si dhe të gjithë aktorëve relevant, është thelbësore për fermerët, pasi do ofronte mbështetje për rrjetin e agroturizmit të Prishtinës.

Konkluzioni

Agroturizmi është një bum i ardhshëm në sektorin e bujqësisë dhe tendenca aktuale në industrinë e turizmit. Ai shërben si një mundësi për fermerët që të përdorin fermën e tyre për të gjeneruar të ardhura. Ai gjithashtu ofron mundësi për njerëzit urbanë për të shijuar jetën dhe aktivitetet rurale. Si fermerët ashtu edhe turistët përfitojnë prej tij, duke e bërë atë një situatë të favorshme. Fermerët mund të rrisin të ardhurat e tyre duke shfrytëzuar resurset në dispozicion, kurse turistët mund të përjetojnë jetën e fshatit me kosto të arsyeshme. Peizazhi rural mund të ruhet nga zhvillimi i agroturizmit. Ndërmarrja përballet me shumë çështje që kërkojnë strategji kreative dhe implikime politikash për përmirësim.

Në këtë drejtim, industria ka nevojë për njohjen e duhur, politika të mbështetura nga qeveria, subvencione, trajnime dhe udhëzime të duhura për fermerët etj.

Faktor me rëndësi të madhe, do ishte krijimi i një Modeli të Partneritetit Strategjik Publiko – Privat, me qëllim të ngritjes dhe rritjes së sektorit të agroturizmit në rajonin e komunës së Prishtinës por edhe në nivel të vendit.

6.2. Hapat dhe strategjitë për zhvillimin e agroturizmit

Tabela 11. Hapat dhe Strategjitë për zhvillimin e agroturizmit në rajonin e komunës së Prishtinës

Nr.	Hapat	Strategjitë
H1.	Vlerësimi i potencialit dhe planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Studimi i fizibilitetit: Hartimi i një studim fizibiliteti për të vlerësuar potencialin për agroturizëm në zonat rurale, duke përfshirë kërkesën e tregut, atraksionet lokale dhe resurset e disponueshme. ➤ Planifikimi Operacional: Zhvillimi i një plani gjithëpërfshirës që përshkruan qëllimet, audiencën e synuar, aktivitetet, nevojat e infrastrukturës dhe strategjitë e marketingut për agroturizmin.
H2	Evidentimi i atraksioneve dhe aktiviteteve Nxitja eksperiencave atraksioneve dhe zhvillimi i aktiviteteve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Inventari i Resurseve Natyrore: ➤ Inventari i Resurseve Bujqësore: ➤ Resurset kulturore dhe historike: ➤ Aktivitete rekreative: ➤ Akomodimi dhe Infrastruktura: ➤ Resurset edukative dhe interpretuese: ➤ Marketingu dhe promovimi: ➤ Qëndrueshmëria dhe Përpjekjet e Ekoturizmit:
		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivitetet bujqësore dhe në Ferma ➤ Kurse gatimi dhe eksperiencia kulinare ➤ Aktivitete në natyrë dhe aventurë ➤ Përvoja kulturore dhe historike ➤ Aktivitete vizituese të fëmijëve, miqësore me familjen ➤ Aktivitete sezonale dhe tematike kulturore ➤ Ture arsimore dhe edukative për agroturizmin dhe Eko-Turizmin.
H3.	Përmirësimi i Infrastrukturës Investimet në strukturat agroturistike	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Objektet: Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të nevojshme, si qendrat e vizitorëve, tualetet, zonat e parkimit, pikat e piknikut dhe të kampingut. ➤ Siguria dhe qasja: Sigurimi që të gjitha objektet dhe aktivitetet të jenë të sigurta dhe të qasshme për një gamë të gjerë vizitorësh, duke përfshirë familjet me fëmijë dhe individët me aftësi të kufizuara. ➤ Sinjalizimet dhe informacionet: Instalimi i tabelave të qarta sinjalizuese, si dhe sigurimi i materialeve informuese për fermën, historinë e saj dhe aktivitetet e ofruara.
		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Akomodimi/strehimi dhe lehtësitë: Ofrimi i mundësive për qëndrime në fermë, fjetje me mëngjes ose kamping për të akomoduar turistët. Sigurimi që të ketë kanalizim të pastër, furnizim me ujë dhe veçori të sigurisë. ➤ Partneriteti publiko - privat në ngritjen e kapaciteteve të akomodimit ➤ Subvencionimi i adaptimit dhe rregullimit të kapaciteteve akomoduese në kuadër të objekteve të fermerëve

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Subvencionimi në ngritjen e kapaciteteve dhe pajisjeve të gastronomisë agroturistike
H4.	Trajnimi dhe Ngritja e Kapaciteteve të stafit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Trajnimi i Stafit: Trajnimi i stafit të fermës. Lidhur me mikpritjen, shërbimin ndaj klientit dhe protokollet e sigurisë për të ofruar një përvojë pozitive të vizitimit. ➤ Menaxhimi i Biznesit: Ofrimi i trajnimeve në menaxhimin e biznesit, marketingun dhe planifikimin financiar për fermerët dhe operatorët, për t'i ndihmuar ata të drejtojnë në mënyrë efektive sipërmarrjet agroturistike.
H5.	Promovimi, marketingu, rrjetëzimi dhe partneritetet në agroturizëm	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Prezenca në internet: Krijimi i një faqeje interneti dhe përdorimi i platformave në mediat sociale, për të promovuar aktivitetet agroturistike dhe për të tërhequr vizitorë. ➤ Bashkëpunime: Partneritet me bordet lokale turistike, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, për të arritur një audiencë më të gjerë. ➤ Marketingu lokal dhe rajonal: Reklamimi në mediat lokale dhe rajonale dhe pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita udhëtimi, për të rritur ndërgjegjësimin për ofertat e agroturizmit. ➤ Angazhimi i komunitetit: Përfshirja e komunitetit lokal në zhvillimin dhe funksionimin e aktiviteteve agroturistike, për të siguruar mbështetjen e komunitetit dhe ndarjen e përfitimeve. ➤ Rrjetet e agroturizmit: Bashkimi ose krijimi i rrjeteve, kooperativave të agroturizmit, si dhe shoqatave të operatorëve agroturistikë, për të ndarë njohuritë, burimet dhe praktikatat më të mira. ➤ DMO Organizata për Menaxhimin e Destinacionit për Agroturizmin.
H6.	Qëndrueshmëria, vlerësimi dhe përmirësimi i praktikave mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Praktikatat e qëndrueshme: Zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe turistike për të minimizuar ndikimin mjedisor dhe për të promovuar turizmin miqësor ndaj mjedisit. ➤ Programet arsimore: Edukimi i vizitorëve lidhur me bujqësinë e qëndrueshme, ruajtjen dhe rëndësinë e mbështetjes së fermave lokale. ➤ Mekanizmi i reagimit: Tubimi i komenteve nga vizitorët për të kuptuar përvojat e tyre dhe për të identifikuar fushat për përmirësim. ➤ Përmirësimi i vazhdueshëm: Rishikimi dhe përditësimi i rregullt i ofertave, objekteve dhe strategjive të marketingut agroturistikë, bazuar në reagimet dhe tendencat e ndryshimit të tregut.
<p>Nëse institucionet relevante të komunës së Prishtinës, me mirëkuptimin dhe përkrahjen e institucioneve qendrore, ndjekin këta hapa dhe strategji, zonat rurale mund të zhvillojnë me sukses agroturizmin, duke u ofruar vizitorëve përvoja unike, duke nxitur ekonominë lokale dhe duke ruajtur trashëgiminë rurale.</p>		

7. Resurset e Trashëgimisë Natyrore dhe Turistike të Rajonit të Komunës së Prishtinës

7.1. Zonat kodrinoro malore të Malësisë së Gallapit ose Gollakut

Gollaku (ose **Gallapi**), është trevë malore në veri dhe kryesisht lindje të Prishtinës, shtrihet mes lumit Batllava dhe Krivareka dhe shtrihet deri në Serbinë Jugore, duke përfshi edhe Medvegjen me rrethinë. Ajo përfshinë gjithashtu fshatra të Komunës së Podujevës, Kamenicës, Artanës (ish-Novo Bërdes] të Komunës së Graçanicës, disa fshatra të Komunës së Gjilanit dhe pjesën dërmuese të qytetit të Prishtinës. Popullsia e kësaj ane, këtë trevë e quan edhe *Malësia e Gallapit*.

7.2. Gjeografia e Gallapit

Malësia e Gallapit/Gollakut shtrihet në lindje të Kosovës, dhe është pak më shumë se 15% e territorit të vendit tonë. Gallapi/Gollaku si një rajon gjeografik i Kosovës, ka më shumë se 120 fshatra, kurse jashtë saj janë mbi 30 fshatra. Harta e Kosovës ka katër cepa. Në veri është Kopaoniku; në perëndim janë Bjeshkët e Namuna; në jug është Sharri, kurse në lindje është Gallapi. Malësia e Gallapit është karakterizuar më herët me një jetë të qetë, idilike. Gallapi si trevë e Kosovës kufizohet me Llapin, me Rrafshin e Kosovës, me Anamoravën si dhe me Karadakun.

Mos zhvillimi ekonomik, e sidomos mungesa e infrastrukturës, ka bërë që shumë fshatra të braktisen nga banorët, dhe tani është krijuar një gjendje me disa fshatra të zbrazura. Një numër i madh fshatrash kanë mbetur me dy a tri shtëpi. Zakonisht, popullata e kësaj ane lëviz për në qytetin e Prishtinës, më përpara edhe në Dardanë dhe më pak në Gjilan. Lagje të tëra qytetesh janë me popullatë nga kjo trevë: në Prishtinë (Kodra e Trimave, Kolovica, Vreshtat, Kolovica e Re, Matiqani, Sofalia, Lagja e Spitalit, Taslixhe I dhe Taslixhe II etj.), dhe po ashtu edhe në Dardanë; familje të shumta tani kanë mërguar në shtetet perëndimore. Fshati më i madh i Kosovës është Marevci, dhe bën pjesë në këtë malësi. Maja më e lartë është në Koznicë me Malin e Madh me 1260 m lartësi mbidetare.

Malësia e Gallapit është kryesisht agrare, me degë kryesore pylltarinë dhe blegtorinë, e më pak lavërtarinë. Një pjesë e kësaj malësie graviton drejt Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër, që e ka më afër Dardanën (Kamenicën), anon kah kjo qendër, ose kah fshatrat tjera të mëdha, bile edhe në drejtim të Gjilanit.

7.3. Biodiversiteti i Malësisë së Gollakut

Biodiversiteti nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në rajonin e Malësisë së Gollakut, i cili, falë kushteve gjeofizike, pedologjike, klimatike dhe lagështisë, paraqet një llojllojshmëri të jashtëzakonshme, si të florës ashtu edhe të faunës.



Figura 2. Kolazh i fotografive të biodiversitetit nga Malësia e Gollakut

Gërmia, që është pjesa më e bukur e qytetit të Prishtinës dhe njihet si mushkëria e Prishtinës, tani park nacional, bie në rajonin e Malësisë së Gollakut, dhe me plot gojë thuhet se kryeqyteti i Kosovës Prishtina oborr të vetin e ka pikërisht këtë malësi. Drunjte që priten nga këto anë shiten jo vetëm në Prishtinë e nëpër Kosovë, por edhe në Shqipëri, në Serbi dhe Maqedoni dhe po bën që malësia e Gollakut të shkatërrohet dhe degradohet në mënyrë të vrazhdë. Një ditë mund të ndodh që oborri i kryeqytetit të Kosovës të mbetet lakuriq.

Ndër atraksionet dhe resurset parësore natyrore bëjnë pjesë edhe **Parku i Madh i Prishtinës** dhe **Parku i Tauk Bahçes** në Prishtinë.

Pikërisht nga kjo malësi, dikur në Prishtinë ka rrjedhur lumi Prishtevka, nga Stallova dhe lumi tjetër Vellusha që rrjedh nga Gërmia, e që janë varrosur para shumë vitesh. Prishtina pa këtë pjesë të kësaj malësie sigurisht se do të ishte një qytet fantazmë, pasi ajri i pastër, freskia dhe shëndeti ambiental në Prishtinë vjen vetëm nga drejtimi i Malësisë së Gallapit.

7.4. Resurset Primare të trashëgimisë kulturore dhe historike të Komunës së Prishtinës

7.4.1. Vlerat trashëgimore: përkatësia kosovare, evropiane dhe botërore

Kosova, territor i përshtatshëm për jetë që nga parahistoria e hershme, është një hapësirë e begatshme me traditë kulturore, sa materiale aq edhe shpirtërore. Trashëgimia e saj u shtresua që nga kulturat e para bujqësore para 8000 vjetëve, mbase dhe më herët. Kjo kulturë, e lindur nga substrati neolitik, u gërshetua me elemente indoevropiane eneolitike dhe krijoi adstratin ilir, që në mesjetë u njoh si arbëror/shqiptar. Kosova, si territor qendror dardan, krijoi identitetin politik me krijimin e shtetit të Dardanisë (IV-I p.K.).

Mbi këtë bazë trashëgimore ndikuan apo u bënë pjesë e shtresimeve edhe kulturat e popujve të tjerë (helene, romake, sllavo serbë, osmane). Është e vlefshme të ceket se identiteti i krijuar në kuadër të shtetit dardan dhe rezistenca e vazhdueshme ndaj romakëve bënë që në vitin 279 të krijohej njësi e veçantë administrative-politike romake, Provinca e Dardanisë. Në antikën e vonë dhe në mesjetë Dardania u gjet nën pushtetin e perandorisë së fuqishme bizantine. Në fund të mijëvjeçarit të parë u

dominua nga shteti bullgar i Samuilut, në shekullin XII u dominua nga shteti mesjetar serb, nga shekulli XV nga perandoria otomane, në kuadër të së cilës u krijua Vilajeti i Kosovës, ndërsa në fillim të shekullit XX iu dha Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene, për të pasuar me rrjedhat e tjera historike, tani më të njohura. Si rrjedhojë e një historie të tillë kishte dhe ndikime e shtresime të llojllojshme kulturore.

Shtresimet e tilla, në Kosovë e kudo, shtrojnë edhe çështjen e përkatësisë etnike. Si rrjedhojë shfaqen dhe mëtimet për përvetësimin e tyre, duke sjell dhe situata absurde. Monumentet kulturore në Prishtinë. Monumentet kulturore në Prishtinë janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin kulturor të kësaj pjese të Kosovës ndër shekuj dhe vite. Monumentet e kulturës në përgjithësi kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një vëmendje të veçantë.

"**Mbretëresha e Dardanisë**" ose **Hyjnesha në Fron** është një artefakt ose figurinë nga terakota, që u gjet gjatë disa gërmime në vendin e mullirit rrotullues të Tjerrtores në Prishtinë, Kosovë në vitin 1956. Ajo daton që nga viti 5700-4500 para erës sonë, nga Epoka Neolitike. Perëndesha e ulur, me duart e saj në ijë, është një ekzemplar i ruajtur mirë i bërë nga balta e pjekur, me përmasa 18.5 cm (7.3 in) e lartë dhe mund të shihet në Muzeun e Kosovës në Prishtinë.

Figura 3. Mbretëresha e Dardanisë - Hyjnesha në Fron



Prishtina, si kryeqytet i Kosovës, është qendra kulturore dhe artistike e zhvillimit të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Kosovë. Departamenti i çështjeve kulturore është vetëm një nga segmentet që i organizon ngjarjet kulturore, të cilat e bëjnë Prishtinën, një nga qytetet me tradita më të theksuara kulturore e artistike.

Lokalitetet parahistorike, neolitike dhe shumë shtresore në rajonin e Prishtinës

- Tjerrtorja-lokaliteti neolitik (Vend zbulimi i Hyjneshës në Fron)
- Lokalitetet arkeologjike në Plandishtë dhe Shevarikë
- Lokaliteti arkeologjik - Quka e Drazhnjës
- Lokaliteti arkeologjik Çuka në Barilevë
- Lokaliteti arkeologjik Kalaja në Kulinë
- Lokaliteti arkeologjik Kulina në Slivovë
- Lokaliteti arkeologjik neolitik në Bardhosh
- Lokaliteti arkeologjik neolitik në Barilevë
- Lokaliteti arkeologjik shumëstresor në Gërmi
- Lokaliteti parahistorik në Grashticë
- Lokaliteti parahistorik në Keqekollë

Kalatë antike në rajonin e komunës së Prishtinës

- Kalaja antike në Butoc
- Kalaja e antikitetit të vonë në Koliq
- Kalaja e antikitetit të vonë në Kolovicë
- Kalaja e antikitetit të vonë në Sharban
- Kalaja e Keqekollës
- Fortifikata e antikitetit të vonë Gjyteti i Grashticës
- Fortifikata Gradina e Sofalisë

Monumente tjera kulturore të rajonit të komunës së Prishtinës

- Katedralja e Nënë Terezës në Prishtinë
- Kompleks banimi Etnoteatri
- Kompleks banimi në Milevc (Selim Ismaili)
- Kompleksi i Çarshisë së vjetër
- Kompleksi i Mitropolisë
- Kulla e Sahatit në Prishtinë

Muzetë në komunën e Prishtinës

- Muzeu Historik Kombëtar - Me një stil Austro-Hungarez, përmban mbi 50,000 objekte në pavijone të ndryshme.
- Muzeu Etnologjik "Emin Gjiku" - Ka monumente kulturore që nga shekulli i 18. Veshmbathje të lashta, enë, orendi, dhe armë të vjetra.

Bibliotekat

▪ Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është themeluar në korrik të vitit 1944. Ajo është institucioni më i lartë i këtij lloji në Kosovë. Me një fond prej mijëra libra, ajo është një nga bibliotekat më të mëdha në rajon. Çdo vit më shumë se 40000 ekzemplarët shtohen në arkivin e bibliotekës. Të përfshirë në këtë bibliotekë janë disa nën-biblioteka si:

- Biblioteka Evropiane,
- Biblioteka e NATO-s,
- Biblioteka e Arti bashkëkohor,
- Biblioteka e Artit Muzikor.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është e vendosur në Kampusin e Universitetit të Prishtinës, përballë Galerisë Kombëtare të Kosovës.

- Biblioteka Hivzi Sylejmani

Teatër

- Teatri Kombëtar i Kosovës në Prishtinë

Muzikë

- Orkestra Filarmonike e Kosovës

Art

- Galeria e Arteve e Kosovës

Muzetë

- **Muzeu Kombëtar i Kosovës** ka një koleksion prej më shumë se 50 mijë ekspozitave të profileve të ndryshme, nga arkeologjia, teknologjia, historia, natyra, etnokultura, folklori, trashëgimia dhe pothuajse çdo gjë që tregon historinë e Kosovës në kohë të ndryshme, nga epoka neolitike. mijëra vjet para Krishtit, deri sot. Muzeu i Kosovës ka një koleksion të gjerë të objekteve arkeologjike dhe etnologjike, duke përfshirë edhe perëndeshën neolitike në terakotën e fronit, të gjetur pranë Prishtinës në vitin 1956 dhe të përshkruar në emblemën e qytetit. Një numër i madh i objekteve nga antikiteti janë ende në Beograd dhe muzeu është plaçkitur në vitin 1999.
- Megjithatë, ndërtimi i muzeut është bërë në vitin 1889 dhe është projektuar në bazë të stilit të ndërtimit Austro-hungarez dhe qëllimi i vërtetë ishte vendosja komandës së lartë ushtarake të asaj kohe. Muzeu është duke punuar në kthimin e 1200 objekteve/artefakteve që janë të rëndësishme për trashëgimia kulturore e Kosovës, të marra nga Serbia në vitin 1998. Muzeu është vendosur në sheshin "Adem Jashari".
- **Muzeu Etnologjik Emin Gjiku** është pjesë përbërëse e Muzeut Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, që gjendet në kompleksin e vjetër të banimit, i përbërë nga katër ndërtesa, dy prej të cilave datojnë nga shekulli i tetëmbëdhjetë dhe dy të tjerë nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Koncepti i Muzeut Etnologjik bazohet në katër tema që përfaqësojnë ciklin e jetës duke përfshirë lindjen, jetën, vdekjen dhe trashëgiminë shpirtërore. Shtëpia e gurit është gjithashtu pjesë e muzeut që sot shërben si qendër e artist bashkëkohor

Pallati i Rinisë dhe Sporteve

Katedralja e së Lumes Nënë Terezës

Veshjet tradicionale në Kosovë

Veshjet tradicionale në Kosovë kanë një vend të veçantë në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës. Ato janë veshje të bëra në shtëpia apo dhe nga specialist të ndryshëm në atë lëmi. Ka mbi 200 lloje të veshjeve dhe stileve të veshjes së rrobave që varen nga ku vini, historisë së fisit tuaj, dhe shumë të tjera. E para është, një plis prej leshi dhe në formë të konit, ndërsa për femrat është një kokore me zakonisht ngjyrë të kuqe.

Ushqimi tradicional në Kosovë dhe Rajonin e Prishtinës

Më e njohura në popullin shqiptarë është **flija**, më e preferueshme në verë. E gatuar me "saç" është specialitet nga kuzhina shqiptare, që përgatit më shpesh në regjionet malore. Tëspishta ëmbëlsirë tradicionale shqiptare, si dhe Bakllava, e njohur por ka origjinë turke. Kuzhina shqiptare është ndikuar nga kuzhinat turke, serbe, kroate, greke, dhe italiane. Në zonat urbane, si në Prizren dhe Gjakovë, janë të njohura **Ushqime në Tavat**, jashtëzakonisht të shijshme dhe të shëndetshme. Gjithashtu, janë të njohura pitet e ndryshme, dhe byreku me djathë.

Trashëgimia Urbane Islame e rajonit të komunës së Prishtinës

- **Xhamia e Mbretit** - Kjo xhami u ndërtua në vitet 1460-1461 nga Sulltan Mehmeti II al-Fatih-u (ashtu siç dëshmohet nga gdhendja e murit mbi derën kryesore të xhamisë), vetëm tetë vite pas

rënies së Konstantinopolit. Ajo gjendet në zemër të qendrës së qytetit të vjetër, dhe është xhamia më e madhe dhe më spikatur e Prishtinës.

- **Xhamia e Çarshisë** - Xhamia e Çarshisë është ndërtimi i Prishtinës së vjetër, e ndërtuar në shekullin e 15 nga Sulltan Bajaziti për të përkujtuar fitoren e osmanëve në vitin 1389. Këtë xhami e quajnë edhe 'Tash Xhamia', që në përkthim do të thotë 'Xhamia e gurit'. Kjo xhami sot gjendet përballë Muzeut të Kosovës.
- **Xhamia e Jashar Pashës**
- **Xhamia e Pirinazit**
- **Xhamia e Llapit**

Sahat kulla

- Kjo Sahat Kullë u ndërtua në shekullin e XIX.

Mbeturinat e themeleve të Hamamit të vjetër

Hamami i madh i Prishtinës

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës

- Rreth 150 m në juglindje nga Kulla e Sahatit, kjo shtëpi e rindërtuar që dikur i përkiste familjes Koçadishi përfaqëson shtëpinë e një tregtari tipik Osman gjatë shekullit 19-të.

Ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës

- Në anën e djathtë të Sahat Kullës është një nga shtëpitë e vetme të mbetura të stilit të shtëpive qytetare të shekullit XIX. Pas Luftës së dytë botërore kjo shtëpi u nacionalizua dhe iu dha në shfrytëzim Sekretariatit për kulturë (homologut të Ministrisë së sotme të kulturës). Akademia e Arteve dhe Shkencave është e vendosur në këtë ndërtesë prej themelimit të saj, në vitin 1975.

Ikonostasi në kishën e Shën Nikollës , dhe dy shtëpi të arqipeshkëvisë

- **Kisha e Shën Nikollës** - Gjatë viteve të fundit, Kisha e Shën Nikollës ka qenë kisha e vetme ortodokse në Prishtinë. U ndërtua në shekullin e XIX, siç duket nga ana e gurë punuesëve nga Maqedonia perëndimore. Ndërtesat në afërsi të kishës janë pronë e Muzeut të Kosovës, ndërsa sot aty gjendet Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

7.4.2. Eventët kulturore dhe sportive në organizim nga Komuna e Prishtinës

1. Prishtina Jazz Festival, Prishtinë, 3 – 8 Maj
2. Prishtina Music Week, Prishtinë, 4-9 NOV
3. Sunny Hill Festival, July 25 – 28
4. Etno Fest 10 – 18 August, fshati Kukaj
5. New Born Festival, 9 gusht
6. PriFilmFest, 14 qershor
7. Panairi i librit në Prishtinë
8. Beerfest, Prishtinë.

8. Vizioni dhe Objektivat e zhvillimit të Agroturizmit në Rajonin e komunës së Prishtinës

Vizioni që kjo Strategji planifikon të arrijë gjatë pesëvjeçarit vijues:

Në vitin 2029, Rajoni i Prishtinës Kryeqytet, do të promovohet dhe përjetohet si një destinacion atraktiv i turizmit në përgjithësi dhe Agroturizmit në veçanti, i cili lidh njerëzit me tokën, përmes natyrës, bujqësisë dhe zhvillimit të integruar rural, përmes arteve, kulturës, historisë dhe trashëgimisë; me njëri-tjetrin dhe për veten e tyre, përmes përvojave skenike, sportit dhe rekreacionit, Wellness dhe shëndetit.

8.1. Vendosja e objektivave të qarta Zhvillimi i Agroturizmit në Rajonin e komunës së Prishtinës

Vendosja e objektivave specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të kufizuara në kohë (SMART) për zhvillimin e turizmit. Këto mund të përfshijnë rritjen e numrit të arritjeve të turistëve, kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit ose rritjen e të ardhurave.

- **Nxitja dhe mbështetja e investimeve në zhvillimin e turizmit të Komunitetit Lokal** (Agroturizmit, Ekoturizmit dhe Turizmit Rural) dhe interesit publik, nëpërmjet investimeve vendore apo investimeve të jashtme direkte.
- **Mbështetja e veprimtarive të sektorit turistik** dhe krijimi i kushteve të favorshme ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre.
- **Angazhimi në zhvillimin dhe mbështetjen e turizmit pritës** ose Inbound.
- **Mbështetja dhe bashkëpunimi me grupet e interesit** në procesin e hulumtimit të tregut, lidhur me resurset dhe produktet turistike, zhvillimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut turistik dhe konkurrencën në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
- **Mbështetja, mbrojtja dhe valorizimi ose zhvillimi i resurseve turistike**, zhvillimi dhe promovimi i produkteve turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunim me grupet e interesit.
- **Angazhimi për mbarëvajtjen, mbrojtjen dhe nxitjen e punësimit në industrinë e turizmit**, duke i dhënë prioritet punësimit të rinjve dhe të femrave;
- **Nxitja, mbështetja dhe promovimi i edukimit dhe trajnimeve profesionale**, si dhe formimi profesional dhe i vazhdueshëm turistik, nëpërmjet institucioneve dhe programeve të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse që mbulojnë fushën përkatëse;
- **Nxitja, mbështetja dhe bashkëpunimi me institucionet publike dhe private** në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit të komunës së Prishtinës.
- **Bashkërendimi i aktiviteteve për zbatimin e dispozitave ligjore**, përfshirë konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e turizmit.
- **Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare** që veprojnë në fushën e turizmit për programet e asistencës që ato ofrojnë.
- **Bashkëpunimi me autoritetet kompetente** për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e vizitorëve vendas apo ndërkombëtar.
- **Përcaktimi i kriterëve për funksionimin e zyrave të informacionit turistik.**
- **Bashkërendimi i aktiviteteve dhe punës me institucionet përgjegjëse** për pajisjen e infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike me sinjalistikën turistike, mbrojtjen e integruar të mjedisit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme dhe dëmtimet në zonat turistike.
- **Administrimi i ankesave të vizitorëve dhe mysafirëve**, vendor apo ndërkombëtar, përfshirë diasporën tonë, ndaj hotelierëve, pronarëve të resortëve turistike, guidave turistike, agjencive

të udhëtimit, operatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për shërbimet e ofruara, dhe ia përcjell për shqyrtim inspektoratit që mbulon fushën e turizmit.

- **Mbështetja, nxitja dhe ndërgjegjësimi i ndërmarrjeve turistike**, që ushtrojnë veprimtari turistike, të turizmit dhe udhëtimeve, strukturave të akomodimit në mikpritjen hoteliere, veprimtarive të gastronomisë, lidhur me përdorimin me efikasitet të resurseve natyrore.

8.2. Udhëzimet dhe orientimet zhvillimore të agroturizmit në Rajonin e Prishtinës

Zhvillimi i agroturizmit mund të jetë një iniciativë shpërblyese, duke përfituar si komunitetet bujqësore të rajoneve rurale të Prishtinës, po ashtu edhe turistët që kërkojnë përvoja autentike rurale. Megjithatë, ai kërkon planifikim të kujdesshëm, rregullorë dhe praktika të qëndrueshmërisë për të siguruar suksesin e tij. Duke ndjekur këto udhëzime, agroturizmi mund të ofrojë mundësi të qëndrueshme rritjeje për zonat rurale të Prishtinës, duke ofruar përvoja kuptimplote dhe edukative për vizitorët.

Udhëzimet dhe Orientimet kryesore për zhvillimin e agroturizmit në Rajonin e Komunës së Prishtinës

Kodi	Udhëzimet	Ndikimi në kërkesën turistike dhe kuptimi i faktorëve
U1.	Studimi i Fizibilitetit dhe vlerësimi interesit lokal lidhur me Agroturizmin	<ul style="list-style-type: none"> • Anketimi i fermerëve dhe pronarëve lokalë: Vlerësimi i interesit të tyre për agroturizmin, pasi ai përfshin drejtpërdrejt fermat ose pronat e tyre. • Hulumtimi i tregut: Identifikimi demografikë, interesat dhe preferencat e mundshme turistike për t'u siguruar që ka një kërkesë për agroturizëm në rajon. • Disponueshmëria e Infrastrukturës: Sigurimi që infrastruktura bazë (p.sh., rrugët, shërbimet komunale, komunikimi) mund të mbështesë flukset e turistëve.
U2.	Zhvillimi i produktit unik agroturistikë	<ul style="list-style-type: none"> • Theksimi i praktikave bujqësore lokale: Paraqitja e metodave tradicionale të bujqësisë, bujqësisë organike, varietetin e të korrave, blegtorinë, etj. • Eksperiencat kulturore: Përfshirja e zakoneve dhe traditave lokale, gastronomia/ushqimi, festivalet dhe zanatet, duke siguruar që ato të jenë të lidhura me eksperiencën e vizitorëve. • Aktivitetet praktike: Ofrimi i aktiviteteve ndërvepruese, si vjelja e frutave/perimeve, turët në fermë, prodhimi i verës, klasa gatimi dhe ushqimi i kafshëve. • Oferta sezonale: Promovoni ngjarje sezonale të tilla si festivale korrjesh, seminare mbjelljeje ose turne të gjetheve të vjeshtës.
U3.	Plani për Zhvillim të Qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria Mjedisore: Sigurimi që aktiviteti turistik të mos dëmtojë mjedisin natyror ose tokat bujqësore. Adoptimi i praktikave miqësore me mjedisin, si menaxhimi i mbetjeve dhe ruajtja e energjisë. • Ruajtja e resurseve dhe eventeve kulturore: Ruajtja e traditave lokale dhe origjinalitetit të jetës rurale. Shmangja e komercializimit që mund të dëmtojë integritetin kulturor të zonës. • Qëndrueshmëria e fermës: Sigurimi që agroturizmi të mbështesë produktivitetin e fermës, në vend që të bëhet një shpërqendrim nga aktivitetet bujqësore.
U4.	Pajtueshmëria ligjore dhe rregullatore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e Zonimit dhe Përdorimit të Tokës: Kontrollimi i ligjeve lokale të zonave, si dhe procedurat e marrjes së lejeve të nevojshme për aktivitetet turistike në tokën bujqësore. • Rregulloret e shëndetit dhe sigurisë: Sigurimi që akomodimet, shërbimet ushqimore dhe objektet e fermave të përmbushin kodet e shëndetit dhe sigurisë ushqimore.

		<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi: Fermerët dhe pronarët e tokave duhet të marrin sigurim adekuat të përgjegjësishë për të mbuluar vizitorët në rast aksidentesh ose dëmtimi të pronës. • Taksat dhe Planifikimi Financiar: Konsultimi me profesionistët e taksave, rreth implikimeve të shtimit të komponentit turistik në një biznes ferme.
